



ANALIZA E GJENDJES SË ARSIMIT

në gjuhët e
bashkësive më të vogla

Република Северна Македонија
Министерство за политички систем
и односи меѓу заедниците



Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria për Sistem Politik dhe
Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive

Управа за развој и унапредување на образованието
на јазиците на припадниците на заедниците
Drejtoria për Zhvillimin dhe Avancimin e Arsimit në Gjuhët
e Pjesëtarëve të Bashkësive

ANALIZA E GJENDJES SË ARSIMIT në gjuhët e bashkësive më të vogla

Shkup, mars 2023

Titulli:	Analiza e gjendjes së arsimit në gjuhët e bashkësive më të vogla
Autorët:	Rozita Bllagojeviq, Ismail Demiroviq Axher Javuz, Marija Nikollova Ellvira Jashar
Bashkëpunëtore:	Maja Cvetanoska, Sara Osmani
Botues:	Drejtoria për Zhvillimin dhe Avancimin e Arsimit në Gjuhët e Pjesëtarëve të Bashkësive, Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive dhe Misioni i OSBE-së në Shkup
Përktheu:	Blerina Starova Zllatku
Dizajn grafik dhe printim:	Polyesterday

ISBN 978-92-9271-071-2



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Shkup

Ky botim është financuar nga Misioni i OSBE-së në Shkup. Përbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimet apo qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup.

PËRMBAJTJA

Parathënie	4
Hyrje	5
Përmbledhje ekzekutive	6
Rreth hulumtimit	7
Metodologjia e hulumtimit	15
Metodat dhe mjetet e hulumtimit	15
Mostra	16
Gjetjet	17
Gjetja 1: Zbatimi i mësimin në gjuhët e bashkësive	17
Gjetja 2: Zbatimi i lëndës zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive	18
Gjetja 3: Përfitime nga zbatimi i masave	19
Gjetja 4: Pengesa në zbatimin me masave për arsimin në gjuhën amtare	19
Gjetja 5: Rekomandime për forcimin e zbatimit të masave për realizimin e së drejtës për arsimim në gjuhën amtare	21
Konkluzione	22
Rekomandime	24
Shtojca	30
Shtojca 1	
Rezultatet e sondazhit mbi gjuhën boshnjake në arsim	28
Shtojca 2	
Rezultatet e sondazhit mbi gjuhën vllahe në arsim	42
Shtojca 3	
Rezultatet e sondazhit mbi gjuhën rome në arsim	53
Shtojca 4	
Rezultatet e sondazhit mbi gjuhën serbe në arsim	62
Shtojca 5	
Rezultatet e sondazhit mbi gjuhën turke në arsim	73
Shtojca 6	
Rezultatet e pyetësorit për shkollat	85
Shtojca 7	
Rekomandime nga Forumi pjesëmarrës	89
Literatura e përdorur	92

PARATHËNIE

Multietniciteti në Republikën e Maqedonisë së Veriut më së shumti pasqyrohet përmes përdorimit të gjuhës amtare në mënyra të ndryshme përgjatë sistemit arsimor, me qëllim që t'ju mundësohet fëmijëve që u përkasin komuniteteve më të vogla etnike të arsimohen në gjuhën e tyre amtare.

Është e drejtë themelore e njeriut të shkollohet në gjuhën amtare dhe si prioritet i Ministrisë për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive është të përfshijë sa më shumë fëmijë që gjuhën e tyre amtare ta mësojnë përmes sistemit arsimor, si dhe të avancohet mësimdhënia që zhvillohet në gjuhët më pak të përfaqësuara mësimore dhe mësimdhënien në lëndët që sigurojnë mësim për gjuhën dhe kulturën e bashkësive që ndjekin mësimin në gjuhë të ndryshme nga gjuha amtare.

Angazhimi i Qeverisë për një shoqëri të barabartë për të gjithë është pasqyruar në hulumtimin “Analiza e gjendjes së arsimit në gjuhët e bashkësive më të vogla etnike”, e cila është realizuar nga Drejtoria për zhvillimin dhe avancimin e arsimit në gjuhët e pjesëtarëve të komuniteteve në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Shkup.

Nëse bëhet një krahasim mes hulumtimit të parë të vitit 2010 dhe të këtij që është realizuar në vitin 2022, është evident një hap i konsiderueshëm përpara si në mësimin e rregullt, ashtu edhe në mësimin zgjedhor të gjuhëve të bashkësive më të vogla.

Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, njësitë e vetëqeverisjes lokale, shkollat, si dhe institucione dhe shoqata tjera do të insistojnë që rekomandimet e dala nga ky hulumtim të realizohen dhe të zbatohen në përputhje me nevojat e bashkësive më të vogla etnike.

Një falënderim të madh Misionit të OSBE-së në Shkup, i cili në bashkëpunim me Drejtorinë për zhvillimin dhe avancimin e arsimit në gjuhët e pjesëtarëve të bashkësive e realizoi këtë hulumtim, financoi plotësisht atë dhe publikimin e tij.

Zëvendëskryeministri i Parë i Qeverisë
dhe Ministri i Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive
Artan Grubi

HYRJE

Në dy dekadat e fundit përpjekjet për avancimin e arsimit në gjuhët e bashkësive kanë qenë mjaft të dukshme, veçanërisht kur bëhet fjalë për hartimin e normave dhe dokumenteve strategjike mbi të cilat bazohet sistemi edukativo-arsimor në RMV. Fatkeqësisht, ato në shumicën e rasteve nuk përmbajnë masa për mbështetje të arsimit të pjesëtarëve të bashkësive më të vogla.

Për këto arsye, zbatimi në terren nuk tregon progres, përkundrazi, vihen re rezultate të dobëta në arsimin në gjuhët e bashkësive më të vogla, gjë që lidhet drejtpërdrejt me mungesën e investimeve në cilësinë e këtij lloji të mësimdhënies, dhe kjo reflektohet në masë të madhe në motivimin dhe përfshirjen e pjesëtarëve të bashkësive më të vogla në të mësuarit në gjuhën amtare ose në të mësuarit zgjedhor të gjuhëve dhe kulturës së bashkësive.

Një varg hulumtimesh në këtë temë tregojnë se mbështetja është kryesisht deklarative dhe se në realitet nuk investohet në përmirësimin e kushteve në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhët e bashkësive më të vogla dhe përfituesit kryesorë të fondeve dhe masave në dispozicion janë dy bashkësitë më të mëdha.

Sistemi arsimor është vendi ku brezave të rinj duhet t'u mësohet respekti reciprok dhe pranimi i dallimeve dhe specifikave të secilës bashkësi në vendin tonë, si dhe mënyra për të kontribuar bashkërisht në forcimin e kohezionit social. E gjithë kjo është një përgatitje për t'u përfshirë në shoqërinë heterogjene evropiane, e cila është e mbushur me dallime gjuhësore, kulturore, fetare etj.

Ndër të tjera, ky hulumtim synon të tërheqë vëmendjen e shoqërisë drejt nevojave të bashkësive më të vogla në procesin arsimor si vend ku vlerat e tyre gjuhësore dhe kulturore duhet të ushqehen dhe promovohen si pjesë e thesarit të përgjithshëm maqedonas. Në këtë periudhë vendimtare tek të rinjtë duhet të zhvillohet ndjenja e përkatësisë ndaj një kulture të caktuar, por në të njëjtën kohë, respekti për të gjitha kulturat e tjera të shoqërisë sonë multikulturore.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Analiza e gjendjes së arsimit në gjuhët e bashkësive më të vogla është sondazhi i dytë i kryer nga Drejtoria për Zhvillimin dhe Avancimin e Arsimit në Gjuhët e Pjesëtarëve të Bashkësive (më tutje në tekst Drejtoria) e Ministrisë për Sistemit Politik dhe Marrëdhëniet Ndërmjet Bashkësive. Sondazhi ka përfunduar gjatë vitit 2022 dhe është mbështetur financiarisht nga Misioni i OSBE-së në Shkup. Sondazhi i parë u krye në vitin 2010 dhe periudha dymbëdhjetëvjeçare kërkon një analizë të konkluzioneve të atëhershme. Analiza e vitit 2022 u përgjigjet pyetjeve nëse ka pasur progres dhe çfarë problemesh hasin pjesëtarët e bashkësive më të vogla gjatë përdorimit të gjuhëve në sistemin arsimor.

Ky sondazh, i realizuar në periudhën maj - nëntor 2022, duhet të përcaktojë arsyet e përfaqësimit të ulët të gjuhëve të pjesëtarëve të bashkësive si në mësimdhënien zgjedhore, ashtu edhe në atë të rregullt. Me qëllim që të ishte relevante dhe e qëndrueshme, hulumtimi u nda në dy pjesë. Pjesa e parë i referohet analizës së rregulloreve vendore, ligjeve dhe akteve nënligjore që rregullojnë sistemin arsimor, strategjive dhe dokumenteve të miratuara nga Qeveria, si dhe dokumenteve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me arsimimin e bashkësive më të vogla. Krahas analizës së dokumenteve vendore dhe ndërkombëtare, u analizuan dhe të dhënat që disponon Drejtoria, përfaqësimi i bashkësive në sistemin arsimor sipas përkatësisë etnike dhe shkollat në të cilat kryhet mësimi zgjedhor dhe i rregullt në gjuhët e bashkësive. Pjesa e dytë e hulumtimit u realizua përmes fokus grupeve dhe pyetësorëve me prindër, pjesëtarë të bashkësisë boshnjake, vllahe, rome, serbe dhe turke, si dhe me mësimdhënës dhe shërbime profesionale të shkollave. Pyetësori u është dërguar edhe 21 komunave, por prej anës së tyre nuk ka ardhur asnjë përgjigje.

Në periudhën e kaluar, shteti ka bërë përparim të konsiderueshëm në përdorimin e gjuhëve të bashkësive më të vogla - gjuha boshnjake është në mësimdhënie të rregullt si gjuhë mësimore nga viti 2018, ndërsa nga viti 2019 gjuha serbe dhe turke mësohen edhe si lëndë zgjedhore Gjuhë dhe kulturë. Por krahas progresit të dukshëm, është e nevojshme që shteti të bëjë përpjekje shtesë, veçanërisht për bashkësinë vllahe dhe rome, në mënyrë që të parandalohet rreziku i zhdukjes së gjuhëve të tyre. Në kuadër të së lartpërmendurës, dhe në bazë të hulumtimit dhe analizës që është bërë, të gjitha palët e interesuara si ministritë, institucionet, pushteti lokal, shkollat, por edhe bashkësitë, duhet të

aktivizohen për të mundësuar qasje më të madhe të gjuhëve të bashkësive për fëmijët në sistemin arsimor. Në veçanti duhet të forcohet komunikimi dhe bashkëpunimi ndërmjet palëve kryesore të interesuara.

RRETH HULUMTIMIT

Të drejtat e njeriut bazohen në parime që promovojnë respektin, drejtësinë, mosdiskriminimin, tolerancën, pranimin e dallimeve dhe dinjitetin personal. Duke pasur parasysh se arsimi është një nga të drejtat themelore të njeriut, shteti duhet të respektojë të drejtën e personave të cilët u përkasin bashkësive, për të mësuar gjuhën e tyre ose për të ndjekur mësimin në atë gjuhë, veçanërisht në mjediset ku ata tradicionalisht banojnë ose ku janë në numër më të madh. Pikërisht këto parime janë të mbërthyer në sistemin arsimor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila që nga pavarësia e saj ka bërë ndryshime të rëndësishme në Kushtetutë dhe ligje në mënyrë që të jetë në përputhje me një sërë dokumentesh ndërkombëtare që trajtojnë të drejtën për arsim dhe përdorimin e gjuhëve të pjesëtarëve të bashkësive në gjithë procesin arsimor, duke filluar nga arsimi parashkollor, deri te ai fillor dhe i mesëm.

Në vitin 2001, Republika e Maqedonisë së Veriut bëri ndryshime të rëndësishme në Kushtetutë¹, ku me Amendamentin IV, populli serb dhe boshnjak u bënë pjesë e Preambulës dhe me Amendamentin VIII, pjesëtarëve të bashkësive iu dha e drejta të arsimohen në gjuhën e tyre në arsimin fillor dhe të mesëm në mënyrë të përcaktuar me ligj. Ndryshimet në Kushtetutë u përfshinë edhe në ligjet që kanë të bëjnë me arsimin, por megjithatë, progresi ishte i ngadalshëm, ndërkohë që gjuhët mësimore mbetën po të njëjtat (maqedonishtja, shqipja, turqishtja dhe serbishtja), ato që përdorshin edhe para ndryshimit të Kushtetutës. Për këtë situatë raporton edhe Komiteti Këshillëdhënës mbi Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare mbi Opinionin e tyre të dytë², i cili thotë: *“Autoritetet duhet të intensifikojnë përpjekjet për zgjerimin e mundësive të pjesëtarëve të pakicave për t’i mësuar gjuhët e tyre, si dhe për arsimim në ato gjuhë, dhe kjo të bëhet në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tyre reale, aty ku janë plotësuar kërkesat e Konventës Kuadër pavarësisht*

1 [UstavSRSM.pdf \(sobranie.mk\)](#)

2 [Microsoft Word - doc \(coe.int\)](#) /Mendimi i dytë i Komisionit Këshillëdhënës, viti 2007

përpyjekjeve të mësipërme, mundësitë për pjesëtarët e bashkësive më të vogla për ta mësuar gjuhën e tyre ose për të zhvilluar mësim në gjuhën e tyre tani janë shumë të kufizuara.”

Duke marrë parasysh Rekomandimet e Hagës në lidhje me të drejtat arsimore të pakicave kombëtare³, Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare⁴ dhe gjetjet dhe rekomandimet e Opinionit të Dytë për Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë të miratuar më 23 shkurt 2007, Qeveria dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) në vitin 2007 miratoi Konceptin⁵ për arsimin dhe edukimin fillor nëntëvjeçar, i cili është në përputhje me përcaktimet për respektimin e identitetit gjuhësor dhe kulturor të pjesëtarëve të bashkësive. Sipas Konceptit dhe Planprogramit nga klasa e tretë deri në të nëntën, shkollat u ofrojnë nxënësve lëndët zgjedhore - Gjuha dhe kultura e vllahëve, romëve dhe boshnjakëve. Nxënësit që zgjedhin këto lëndë mund t'i mësojnë në vazhdimësi deri në klasën e nëntë, me një ose dy orë në javë.

Koncepti i arsimit fillor nëntëvjeçar i plotësoi vetëm pjesërisht kërkesat e pjesëtarëve të bashkësive për të mësuar gjuhët e tyre në sistemin arsimor. Përkundër kërkesave të bashkësisë turke dhe serbe që gjuhët e tyre të mësohen si lëndë zgjedhore në mjedise ku nuk ka kushte për mësim të rregullt, kjo është refuzuar nga ana e Byrosë për Zhvillimin e Arsimit (BZHA) me arsyetimin se ekziston mësim i rregullt në gjuhët e tyre. Në të njëjtën kohë, bashkësisë boshnjake iu hoq e drejta për mësim në gjuhën amtare,⁶ edhe pse në vitin 2006 MASH-i dha pëlqimin për punë edukativo-arsimore në gjuhën boshnjake.

Situata pas konfliktit, Marrëveshja Kornizë e Ohrit dhe ndryshimet kushtetuese patën ndikim të madh në marrëdhëniet ndëretnike, veçanërisht në kategorinë më të cënueshme - nxënësit. Në vitin 2009, zyra e UNICEF-it në Shkup zhvilloi Studimin mbi multikulturalizmin dhe marrëdhëniet ndëretnike në arsim⁷, duke analizuar gjendjen aktuale dhe kapacitetet e sistemit arsimor, qëllimi i të cilit ishte të kontribuojë në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike në vend. Nga Studimi dolën një sërë rekomandimesh, duke përfshirë:

3 32188.pdf (osce.org)

4 FCNM in Macedonian (coe.int)

5 www.bro.gov.mk/ Koncept për arsimin dhe edukimin nëntëvjeçar fillor

6 Shiko Baza për planifikim 2006. MASH-BZHA

7 https://www.unicef.org/northmacedonia/media/1826/file/MK_MulticulturalismInEducation_MK.pdf

- të sigurohet mësimi i ndonjëres prej gjuhëve të bashkësive etnike (p.sh. shqip, turqisht, serbisht) dhe kjo të trajtohet si më e rëndësishme se mësimi i një gjuhe të dytë të huaj;
- të krijohen kushte me të cilat gjuha e bashkësive etnike që e zgjedh nxënësi të mund të zotërohet gjatë shkollimit të rregullt së paku në nivelin e komunikimit bazë.

Sa i përket edukimit parashkollor, në vitin 1998 u vendos programi parashkollor multikulturor dygjuhësor Mozaik, i cili zbatohet në grupmosha të përziera në kopshtet ekzistuese. Programi Mozaik zbatohet në dy gjuhë, mes maqedonishtes, shqipes, turqishtes, serbishtes, të përdorura në përputhje me nevojat e çdo bashkësie. Në vitin 2012, grupet e Mozaik-ut u institucionalizuan si pjesë e sistemit arsimor në Maqedoninë e Veriut⁸.

Bazuar në gjetjet e disa hulumtimeve dhe rekomandimeve për marrjen e masave urgjente për krijimin e një sistemi arsimor të integruar dhe multikulturor, Ministria e Arsimit dhe Shkencës në vitin 2010 miratoi Strategjinë “Një hap drejt arsimit të integruar në sistemin arsimor”, qëllimi i së cilës ishte promovimi i multikulturalizmit dhe integritit ndëretnik. Strategjia është e ndarë në pesë grupe tematike:

- Promovimi i integritit përmes aktiviteteve të përbashkëta;
- Integrimi përmes mësimi të gjuhës;
- Plan-programe mësimore dhe tekste shkollore;
- Kualifikimet e mësimeve;
- Menaxhimi i shkollave në kontekstin e decentralizimit.

Grupi i dytë tematik “Integrimi përmes mësimi të gjuhës” kishte qëllime të përcaktuara qartë, aktivitete për mësimin e gjuhës së fëqinjt dhe mësimin e hershëm të gjuhës maqedonase për fëmijët me gjuhë tjetër amtare. Megjithatë, ky grup tematik nuk është shqyrtuar fare nga grupi punues, pavarësisht insistimit të përfaqësuesit të Drejtorisë. Shkakun për këtë e gjejmë në mungesën e vullnetit politik për të realizuar aktivitetet e këtij grupi tematik.

Me qëllim të përmirësimit të situatës, në vitin 2010, Drejtoria për Zhvillimin dhe Avancimin e Arsimit në Gjuhët e Pjesëtarëve të Bashkësive në bashkëpunim

8 <https://www.sfcg.org/mozaik-education-macedonia/>

me Misionin e OSBE-së në Shkup realizuan një hulumtim me temën “Kushtet në arsimin fillor të fëmijëve të pjesëtarëve të bashkësive në Republikën e Maqedonisë”. Bazuar në hulumtimin dhe të dhënat e marra nga sondazhi i kryer, Drejtoria erdhi deri te konkluzionet në vijim:

- Një numër shumë i vogël nxënësish mbulohej me lëndët zgjedhore Gjuha dhe kultura e boshnjakëve, vllahëve dhe romëve;
- Informimi i dobët i prindërve dhe nxënësve për mundësinë e mësimit të gjuhës së bashkësisë si lëndë zgjedhore;
- Anketa të vonuara ose të pazbatuara nga shkollat në lidhje me informimin për mësimin e gjuhëve të bashkësive si lëndë zgjedhore;
- Numri i lartë i nxënësve (15) si kriter për formimin e klasës;
- Mungesa e trajnimeve për kuadrin mësues;
- Mungesa e mundësisë për t'i mësuar gjuhët e bashkësive në institucionet e arsimit të lartë (gjuhën boshnjake, vllahe dhe rome)
- Mungesa e teksteve shkollore, por edhe e librave për lëndët zgjedhore.

Analiza e hulumtimit të kryer tregon se deri sot ka pasur progres. Lëndët zgjedhore Gjuha dhe kultura e boshnjakëve dhe e vllahëve janë të mbuluara plotësisht me tekste shkollore nga klasa e tretë deri në klasën e nëntë, ndërsa ka pak progres në lidhje me informimin e prindërve për të drejtën për të mësuar një gjuhë si lëndë zgjedhore. Kryesisht problemet mbetën të njëjta, gjë që vërteton në fakt analizën e bërë me hulumtimin e dytë dhe pasqyron realisht gjendjen e arsimit në gjuhët e bashkësive që nga ndryshimet e Kushtetutës në vitin 2001 e deri më sot.

Vështirësi në mësimin e gjuhëve të pjesëtarëve të bashkësive raporton edhe Komisioni Këshillëdhënës në Opinionin e Katërt⁹, i cili shpreh keqardhjen që pavarësisht kërkesave për mësimin e gjuhëve, ato janë refuzuar në nivel lokal, veçanërisht në komunat ku bashkësitë më të vogla janë dominuese. Bëhet fjalë për komunat e Manastirit dhe Prilepit, ku ka një numër të madh të nxënësve që i përkasin bashkësisë rome, por gjithashtu Komisioni përshëndet faktin që gjuha boshnjake mësohet në shkollë si program eksperimental.

9 [DisplayDCTMContent \(coe.int\)](#) /Mendimi i katërt i Komisionit Këshillëdhënës, viti 2016

Përmes një programi eksperimental, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, me vendim të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës nga viti 2018/19, ka futur gjuhën boshnjake si gjuhën e pestë mësimore në arsimin fillor.

Për të përmbushur kërkesat e bashkësisë serbe dhe turke për mësimin e gjuhës amtare si lëndë zgjedhore në mjedise ku nuk ka mundësi për mësim të rregullt, me ndryshimet e planprogramit, nga viti 2019 u futën: Gjuha dhe kultura e serbëve dhe e turqve. Të gjitha këto ndryshime konfirmojnë përcaktimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për të respektuar plotësisht identitetin dhe interesin e të gjithë qytetarëve të saj, në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe nenet 12 dhe 14 të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.

Në fushën e teksteve shkollore, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka bërë përpjekje për të siguruar tekste shkollore për pjesëtarët e bashkësive që mësojnë gjuhën amtare si lëndë zgjedhore Gjuha dhe kultura e boshnjakëve, vllahëve, romëve, serbëve dhe turqve¹⁰. Për dy bashkësitë e para ka tekste shkollore nga klasa e tretë deri në të nëntën dhe gjenden si në formë të shtypur ashtu edhe në formë elektronike, por pjesëtarët e bashkësisë romë ende nuk kanë tekste shkollore për gjuhën dhe kulturën romë për klasën e gjashtë, të shtatë, të tetë dhe të nëntë. Për pjesëtarët e bashkësisë serbe dhe turke, BZHA ka hartuar programe mësimore nga klasa e tretë deri në klasën e nëntë dhe aktualisht është duke punuar në tekstet shkollore për klasën e tretë dhe të katërt. MASH, përmes Shërbimit pedagogjik, në vazhdimësi shpall Konkurs për hartimin e teksteve shkollore, veçanërisht për Gjuhën dhe kulturën e romëve, por nuk ka të interesuar që janë paraqitur për përpilimin e tyre. Përpilimi i teksteve shkollore shoqërohet me një sërë problemesh, veçanërisht në pjesën e recensentëve, gjë që lidhet ngushtë me normativin për kuadrin mësimor.¹¹ Për këtë nevojitet një ndryshim në normativin për kuadrin mësimor, e si rrjedhojë edhe në Ligjin për tekstet shkollore.

Nga ana e Fondacionit Shoqëria e Hapur Maqedoni është realizuar hulumtimi *“Arsimi në gjuhët e bashkësive më të vogla etnike”*¹². Subjekti i analizës është arsimit në gjuhën mësimore të bashkësive më të vogla etnike, si dhe kultivimi i gjuhës dhe kulturës së bashkësisë, gjegjësisht realizimi i masave:

10 [Zakon za ucebници za osnovno i sredno obrazovanje-pdf.pdf \(mon.gov.mk\)](#)

11 Shiko Programe mësimore për Gjuhën dhe kulturën e bashkësive 2018

12 https://fosm.mk/wp-content/uploads/2020/04/obrazovanie-na-jazicite-na-pomalubrojnite-etnicki-zaednici_06.pdf

- a) mësim në gjuhët e bashkësive më të vogla etnike,
- b) lënda zgjedhore Gjuha dhe kultura e pjesëtarëve të bashkësive më të vogla etnike.

Rekomandohen disa aktivitete dhe masa për zbatimin dhe avancimin më të suksesshëm të arsimit të pjesëtarëve të bashkësive më të vogla etnike dhe lëndës zgjedhore Gjuhë dhe kulturë.¹³ Në konkluzionet e tij, FSHM ofron një sërë rekomandimesh që do të përmirësonin mësimin e gjuhës për pjesëtarët e bashkësive më të vogla etnike.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës në vitin 2018 miratoi Strategjinë e Arsimit 2018 - 2025, e cila kryesisht synon:

- Përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe theksimin e rëndësisë së tij për prioritetet zhvillimore të shoqërisë maqedonase (veçanërisht kur bëhet fjalë për formimin e qytetarëve produktivë dhe të angazhuar) dhe për nevojat e tregut të punës, drejt realizimit të rezultateve të pritura nga mësimi si dhe për pranimin e multikulturalizmit, integritit ndëretnik, respektimit të dallimeve dhe vlerave demokratike;
- integrimin të nxënësve që u përkasin bashkësive të ndryshme etnike përmes aktiviteteve të përbashkëta shkollore dhe jashtëshkollore, mësimi të përbashkët të gjuhëve;
- përmirësimin e kushteve hapësinore për integrim, sigurimin e kompetencave sociale dhe shoqërore ndërpersonale dhe ndërkulturore;
- regjistrimin e fëmijëve në shkollë në moshën e përshtatshme, pavarësisht prejardhjes dhe aftësive të tyre, veçanërisht fëmijët nga grupet e marginalizuara (për shembull fëmijët romë) dhe të sigurohet që ata të kryejnë një minimum të arsimit fillor;
- ofrimin e bursave dhe nxënies dhe mentorimit për nxënësit romë në shkollat e mesme.

Në Raportin e Komisionit Evropian për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë për vitin 2018 në fushën e arsimit, vihet re se vendi ka shënuar progres mesatar me miratimin e Strategjisë gjithëpërfshirëse për arsim. Rekomandimet për vitin 2018 kanë për qëllim:

13 Shiko f. 14,15 https://fosm.mk/wp-content/uploads/2020/04/obrazovanie-na-jazicite-na-pomalubrojinite-etnicki-zaednici_06.pdf

- a) realizimin e objektivave dhe aktiviteteve të Strategjisë;
- b) rritjen e mbështetjes për trajnimin e mësimdhënësve dhe zhvillimin e tyre në karrierë;
- c) qasjen më të mirë në arsim cilësor për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët e bashkësisë rome.

Gjatë vitit 2021, Ministria e Arsimit dhe Shkencës miratoi Konceptin për Arsimin Fillor¹⁴, sipas të cilit, përveç lëndëve të detyrueshme, çdo shkollë mund të ofrojë lëndë zgjedhore që rrjedhin nga interesat e shprehura të nxënësve që mësojnë në atë shkollë, duke i marrë parasysh njëkohësisht dhe mundësitë e kuadrit mësimor që punon në shkollë dhe burimet që disponon shkolla.

Në fakt, çdo shkollë duhet të ofrojë dy lista të lëndëve zgjedhore, njërin për mësimin e një gjuhe të dytë të huaj dhe tjetrën për të ashtuquajturat “lëndë të lira zgjedhore” që ofron shkolla, në varësi të interesave të nxënësve dhe mundësive të shkollës. Përveç këtyre, shkollat mund të ofrojnë edhe lëndë zgjedhore që kanë të bëjnë me mësimin e gjuhës së bashkësisë, mësimin e gjuhës së dytë zyrtare në komunë, mësimin e gjuhës shqipe dhe/ose mësimin e kulturës dhe gjuhës së bashkësive më të vogla etnike për pjesëtarët e tyre.

Risi në Koncept është mësimi i gjuhës së bashkësisë si lëndë zgjedhore nga klasa e katërt, e destinuar për mësimin e gjuhës së dytë zyrtare në komunë, ku numri i banorëve të bashkësisë duhet të jetë më i madh se 20% e popullsisë së përgjithshme brenda komunës, një shifër shumë e madhe për shumicën e pjesëtarëve të bashkësive etnike. Për shkak të këtyre vendimeve ligjore dhe të tjera të ngjashme, me anë të të cilave bashkësitë më të vogla nuk kanë të njëjtin status vetëm e vetëm për shkak të përfaqësimit në përqindje, përqindja e folësve të gjuhëve të bashkësive më të vogla është dukshëm në rënie e rrjedhimisht edhe mësimi i këtyre gjuhëve në sistemin arsimor. Këtë e tregojnë edhe të dhënat nga Regjistrimi i popullsisë në vitin 2021¹⁵ sipas të cilit numri i popullsisë të të gjitha bashkësitë etnike ka rënë dukshëm, e bashkë me të edhe numri i folësve të gjuhës së bashkësive më të vogla, gjë e cila vë në pikëpyetje mbijetesën e gjuhës së bashkësive. Sipas të dhënave të regjistrimit, të paraqitura në tabelën e mëposhtme, më e kërcënuara është gjuha vllahe.

14 www.bro.gov.mk/

15 <http://popis2021.stat.gov.mk/>

Tabela 1. Përfaqësimi i bashkësive dhe i folësve të gjuhës së bashkësive

Përkatësia etnike	Përqindja e bashkësive	Folësit e gjuhës së bashkësive
Turq	3.86%	3.41%
Romë	2.53%	1.73%
Serbë	1.30%	0.61%
Boshnjakë	0.87%	0.85%
Vllahë	0.47%	0.17%

Në përputhje me planin mësimor, gjuhë mësimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përveç maqedonishtes dhe shqipes, janë edhe turqishtja, serbishtja dhe boshnjakishtja, kurse lëndë zgjedhore që mundësojnë mësimin e gjuhës së bashkësive janë Gjuha dhe kultura e vllahëve, Gjuha dhe kultura e romëve, Gjuha dhe kultura e boshnjakëve, Gjuha dhe kultura e serbëve dhe Gjuha dhe kultura e turqve.

Sipas të dhënave që disponon Drejtoria, gjuha turke si gjuhë mësimore në arsimin fillor mësohet në 27 komuna dhe 41 shkolla, kurse lënda zgjedhore Gjuha dhe kultura e turqve realizohet në 5 komuna dhe 5 shkolla. Në arsimin e mesëm, gjuha turke si gjuhë mësimore është e përfaqësuar në 9 komuna dhe 15 shkolla.

Gjuha serbe si gjuhë mësimore është e përfaqësuar në tri komuna dhe tri shkolla fillore, kurse lënda zgjedhore Gjuha dhe kultura e serbëve realizohet në tri komuna dhe pesë shkolla.

Gjuha boshnjake si gjuhë mësimore në arsimin parashkollor evidentohet në një kopsht, në arsimin fillor mësohet në dy komuna dhe dy shkolla, ndërsa lënda zgjedhore Gjuha dhe kultura e boshnjakëve realizohet në pesë komuna dhe tetë shkolla. Gjuha boshnjake nuk është e pranishme në arsimin e mesëm.

Për momentin, bashkësia vllahë në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ka të drejtë mësimi në gjuhën e amtare në asnjë nivel të sistemit arsimor. Sa i përket arsimit parashkollor, nuk ka asnjë kopsht në të cilin procesi edukativo-arsimor zhvillohet në gjuhën vllahë, por nga shkurti i vitit 2022 në çerdhen “Gonxha Tufa” në Krushevë ka nisur sensibilizimi me gjuhën vllahë për grupmoshën më të vjetër (fëmijët nga 5-6 vjeç). Një iniciativë për futjen e gjuhës vllahë në kopshtet ku janë të pranishëm pjesëtarët e kësaj bashkësie është nisur nga

bashkësia vllahe në disa komuna: Manastir, Aerodrom, Kisella Vodë, Karposh dhe Shtip.

Lënda zgjedhore Gjuha dhe kultura e vllahëve realizohet në katër komuna dhe shtatë shkolla.

Romët si bashkësi etnike nuk kanë mësim në gjuhën rome, andaj më së shumti ndjekin mësim në gjuhën maqedonase dhe shqipe, si në arsimin fillor ashtu edhe në atë të mesëm. Lënda zgjedhore Gjuha dhe kultura e romëve realizohet në gjashtë komuna dhe 13 shkolla.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Subjekti i analizës është zbatimi i masave arsimore për realizimin e të drejtës për arsimim të pjesëtarëve të bashkësive më të vogla:

- Të nxënit në gjuhët e bashkësive më të vogla
- Lënda zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive

Pyetjet të cilave duhet t'u përgjigjet kjo analizë janë:

- A kryhet mësimi në gjuhët e bashkësive më të vogla kudo ku ka banorë nga bashkësia boshnjake, vllahe, serbe, rome dhe turke?
- A zbatohet lënda zgjedhore Gjuha dhe kultura e pjesëtarëve të bashkësive më të vogla kudo ku ka banorë nga bashkësia boshnjake, vllahe, serbe, rome dhe turke, në shkollat ku nuk zhvillohet mësim në gjuhën amtare të këtyre bashkësive?
- Cilat janë përfitimet nga zbatimi i tyre?
- Cilat janë pengesat/vështirësitë në zbatimin e tyre?
- Si mund të forcohet zbatimi i këtyre masave aty ku ka pjesëtarë të bashkësive më të vogla?

Metodat dhe mjetet e hulumtimit

Për qëllimet e këtij hulumtimi, janë mbledhur të dhëna sasiore dhe cilësore përmes **anketave dhe diskutimeve në fokus grupe**.

Për anketën u përgatitën tre pyetësorë: për prindërit, shkollat dhe komunat dhe u dërguan "online" përmes Drejtorisë, komunave dhe shkollave, të cilët

ua shpërndanë të anketuarve linkun e pyetëtorit. Në këtë mënyrë, u garantua privatësia dhe anonimiteti i përgjigjeve të të gjithë të anketuarve.

Për fokus grupet u përgatitën dy protokolle diskutimi: një me prindërit dhe një me mësimdhënësit dhe përfaqësuesit e shërbimit profesional nga shkollat dhe kopshtet.

U mbajtën konsultime më të gjera në kuadër të Forumit pjesëmarrës në bashkëpunim me Agjencinë për Realizimin e të Drejtave të Bashkësive dhe Drejtorinë për Zhvillimin dhe Avancimin e Arsimit në Gjuhët e Pjesëtarëve të Bashkësive dhe me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Shkup, me përfaqësues nga disa institucione relevante dhe organizata të shoqërisë civile. Për këtë seancë është përdorur metoda e planifikimit strategjik, e quajtur Planifikimi retrograd (Backcasting), me anë të së cilës janë arritur rekomandimet kryesore për vitin e ardhshëm, të cilat i dorëzohen Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Mostra

Mostra përbëhet nga prindër nga bashkësitë më të vogla, të cilët kanë një ose më shumë fëmijë të përfshirë në arsimin parashkollor, fillor dhe/ose të mesëm.

Pyetëtorit për prindër iu përgjigjen gjithsej 1186 prindër ose anëtarë të ngushtë të familjes më të afërt. Prej tyre, 405 deklaruan se fëmija i tyre i përket njërit prej pesë bashkësive që janë në fokus të këtij hulumtimi (149 bashkësisë boshnjake, 89 bashkësisë vllahe, 86 bashkësisë rome, 41 bashkësisë serbe dhe 40 bashkësisë turke). 781 të tjerët deklaruan se fëmija i tyre nuk i përket asnjërit prej këtyre pesë bashkësive, kështu që përgjigjet e tyre nuk ishin subjekt analize.

Gjithsej 52 prindër morën pjesë në **fokus grupe** (14 nga bashkësia boshnjake, 12 nga bashkësia vllahe, gjashtë nga bashkësia rome, 13 nga bashkësia serbe dhe shtatë nga bashkësia turke).

Mostra përfshin mësimdhënësit dhe përfaqësues nga shërbimi profesional nga të gjitha shkollat në mjediset ku ka një popullatë dominuese të ndonjërit prej bashkësive më të vogla.

Pyetëtorit për shkollë i janë përgjigjur 55 shkolla fillore. Në fokus grupe morën pjesë gjithsej 61 përfaqësues nga shkollat dhe kopshtet.

Në **Forum**in pjesëmarrës u ftuan përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, Shërbimi Pedagogjik, Avokati i Popullit, si dhe organizata të shoqërisë civile.

Mostra është e përshtatshme, gjë që duhet të merret parasysh gjatë nxjerrjes së konkluzioneve. Me këtë hulumtim, gjetjet janë të kufizuara duke u bazuar te të anketuarit që kanë marrë pjesë në fokus grupe dhe u janë përgjigjur pyetësorëve. Ato nuk mund të përgjithësohen për të gjithë popullatën. Pjesëmarrësit e fokus grupeve u përzgjedhën nga zonat me numrin më të madh të banorëve-pjesëtarë të bashkësive, ndërsa “online” pyetësi për prindërit dhe shkollat iu dha të gjithë prindërve dhe të gjitha shkollave ku jetojnë qytetarë nga bashkësitë më të vogla në vend.

Për të siguruar kushtet e anonimitetit gjatë përgjigjes së pyetësorëve, është përdorur plotësimi “online”, me të cilin të anketuarit i është garantuar privatësia, pasi shkolla nuk ka ndërmjetësuar në mbledhjen e pyetësorëve dhe përgjigjet janë grumbulluar drejtpërdrejt në bazën “online” të të dhënave. Nga ana tjetër, duhet pasur parasysh se kjo qasje ka përjashtuar përfshirjen e prindërve që nuk kanë qasje në teknologji.

GJETJET

Ky seksion paraqet gjetjet e integruara në lidhje me mësimin e gjuhës amtare në pesë bashkësitë më të vogla, bazuar në rezultatet e pyetësorëve për prindër dhe fokus grupeve me prindërit dhe përfaqësuesit e shkollave, si dhe në rezultatet e pyetësorit për shkolla. Rezultatet nga këto katër burime janë paraqitur në Shtojcat 1-6 të këtij dokumenti. Rekomandimet nga Forumi Pjesëmarrës me aktorë të ndryshëm nga institucionet relevante arsimore dhe shoqëria civile janë paraqitur në Shtojcën 7.

Gjetja 1:

Zbatimi i mësimin në gjuhët e bashkësive

Mësimi i rregullt në gjuhën amtare nuk zhvillohet në gjuhët vllahe dhe rome, por zhvillohet pjesërisht në gjuhën boshnjake, serbe dhe turke.

Shumica e prindërve nga secili prej pesë bashkësive janë të njohur me të drejtën e arsimimit në gjuhën amtare, megjithatë të paktën një në dhjetë prindër në secilën bashkësi nuk e ka këtë informacion. Më shumë se gjysma e prindërve nga secila prej bashkësive raportojnë se nuk kanë marrë informacion nga kopshti dhe shkolla e fëmijës së tyre për faktin se mësimi ofrohet në gjuhën e tyre amtare.

Përkundër dëshirës së shprehur që fëmijët e tyre të mësojnë në gjuhën amtare, prindërit ndajnë edhe shqetësimin e tyre se nëse fëmijët e ndjekin arsimin fillor në gjuhën amtare, do të kenë vështirësi në mësimin e gjuhës maqedonase në nivelet më të larta arsimore. Për shembull, prindërit nga bashkësia turke raportojnë se mësimi në gjuhën turke zhvillohet kryesisht në shkollat rajonale nga klasa e parë deri në të pestën, ku mbizotëron popullsia turke dhe nga klasa e gjashtë fëmijët vazhdojnë në godinat qendrore, në gjuhën maqedonase, ku suksesi i tyre bie në mënyrë drastike për shkak të njohjes së pamjaftueshme të gjuhës.

Gjetja 2:

Zbatimi i lëndës zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive

Lënda zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive studiohet në një numër të vogël shkollash, siç raportojnë gjysma e prindërve të bashkësisë boshnjake, një e treta e prindërve të bashkësisë vllahe dhe një e dhjeta e prindërve të bashkësisë rome. Prindërit nga bashkësia serbe dhe turk raportojnë se kjo lëndë nuk mësohet fare në shkollat e fëmijëve të tyre. Disa mësimdhënës dhe përfaqësues nga shërbimi profesional raportojnë se nuk kanë informacion të qartë se si t'i informojnë prindërit për këtë mundësi.

Përkundër qëndrimit pozitiv të shprehur nga shumica e prindërve nga të gjitha bashkësitë për zgjedhjen e kësaj lënde, në shumicën e shkollave nuk formohet paralele për mësimin e saj e as nuk zbatohet anketë për të shprehur interesin, ndërsa në disa shkolla nuk jepet fare informacion lidhur me faktin se ekziston mundësia për formimin e një klase që do të ndjekë lëndën zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive.

Shkollat konfirmojnë se lënda zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive mësohet shumë rrallë. Në shkollat ku mësohet, numri i nxënësve që e zgjedhin është shumë i ndryshueshëm nga një shkollë në tjetrën dhe në disa prej tyre është shumë më i ulët se minimumi i parashikuar prej 15 nxënësish.

Disa përfaqësues të shkollës mendojnë se hapja e një klase për këtë lëndë zgjedhore varet në masë të madhe nga qëndrimi dhe përkushtimi i drejtorisë së shkollës, ndonëse në shumicën e rasteve faji bartet te prindërit dhe te interesimi i tyre i dobët për të mësuarit e kësaj lënde zgjedhore, diçka që bie në kundërshtim me qëndrimin pozitiv të tyre në raport me mësimin e gjuhës dhe kulturës së bashkësisë së tyre, të cilin e kanë shprehur fuqishëm.

Në fusha të caktuara janë vënë re edhe veprime për të demotivuar nxënësit dhe prindërit nga të zgjedhurit e kësaj lëndë zgjedhore¹⁶.

Gjetja 3:

Përfitimet nga zbatimi i masave

Përfitimet e fëmijëve të bashkësive më të vogla nga mësimi i gjuhës amtare kryesisht shihen në mundësinë që fëmija të ketë sukses më të mirë në shkollë për faktin se mund të shprehet më mirë dhe më lehtë në gjuhën amtare. Po aq e rëndësishme është edhe mundësia për të kultivuar gjuhën amtare letrare dhe kulturën e vet, gjë që theksohet veçanërisht nga prindërit e bashkësisë vllahe, të cilët thonë se tashmë ekziston rreziku që gjuha vllahe të zhduket nga këto zona, sepse flitet gjithnjë e më pak brenda familjeve.

Disa prindër nga bashkësia serbe dhe turke theksuan se fëmijët që e njohin gjuhën e tyre amtare do të jenë më të përgatitur për ta vazhduar shkollimin në Serbi dhe në Turqi.

Gjetja 4:

Pengesat në zbatimin e masave për arsimim në gjuhën amtare

Ekzistojnë perceptime të ndryshme ndërmjet prindërve dhe përfaqësuesve të shkollave lidhur me identifikimin e pengesave për realizimin e mësimin në gjuhën amtare dhe për lëndën zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive. Përfaqësuesit

16 Shënim nga një këshilltar i Drejtorisë: përfaqësuesit e disa komunave ku është kryer anketa kanë refuzuar të dorëzojnë pyetësorin në kopshtet e komunës së tyre; drejtorë të cilët vetëm për këtë lëndë zgjedhore i kontrollojnë deklaratat e nxënësve dhe prindërve në lidhje me mësimin e GJKV; mësimdhënës të lëndëve të tjera që i dekurajojnë nxënësit me argumentin se nuk do të "përfitojnë" nga kjo gjuhë etj.

e shkollave konsiderojnë se pengesa kryesore është niveli i ulët i interesimit të prindërve për të mësuar gjuhën dhe kulturën e tyre, ndërkohë që prindërit e shohin pengesën kryesore në mungesën e gatishmërisë dhe transparencës së institucioneve arsimore për zbatimin e këtyre dy masave. Prindërit besojnë se pengesat kryesore janë mungesa e kuadrit të kualifikuar dhe kriteret e paqarta për përzgjedhjen e tyre, mungesa e programeve mësimore dhe teksteve shkollore në gjuhët e bashkësive, mungesa e vullnetit nga ana e drejtorisë së shkollës, e shpeshherë është një kombinim i disa faktorëve. Më tej, rezultat i mungesës së transparencës së shkollave në aspektin e masave për realizimin e të drejtës për arsimim në gjuhën amtare janë prindërit e painformuar dhe numri i vogël i nxënësve të paraqitur.

Vetëm një pjesë e vogël e shkollave raportojnë se kuadri mësimor për lëndën Gjuha dhe kultura e bashkësive është sipas normativit. Gjithashtu, një numër i vogël shkollash raportojnë se ofrojnë mbështetje për mësimdhënësit që japin këtë lëndë zgjedhore.

Për prindërit nga shumica e bashkësive është gjithashtu një pengesë e madhe që lënda zgjedhore të ofrohet jashtë programit, në formë të orëve shtesë pas orëve të rregullta, që paraqet një ngarkesë më shumë për fëmijët dhe familjet. Qëndrimi pas orëve të mësimt është i pamundur për ata fëmijë që udhëtojnë me transport të organizuar nga vende më të largëta, sepse nuk kanë mundësi të kthehen në shtëpi nëse nuk përdorin transportin që u ofrohet menjëherë pas përfundimit të orëve të rregullta.

Si pengesë shtesë për arsimimin në gjuhën rome, prindërit nga bashkësia rome përmendin diskriminimin ndaj romëve në shoqërinë tonë, gjë që për ta përfaqëson një arsye për t'u shqetësuar për sigurinë e fëmijëve të tyre. Ata besojnë se fëmijët e tyre do të jenë më të mbrojtur nëse e mësojnë mirë gjuhën maqedonase.

Prindërit nga bashkësia turke raportojnë se një pengesë e madhe për fëmijët që ndjekin mësimin në gjuhën turke deri në klasën e pestë është pamundësia për të vazhduar shkollimin në gjuhën turke në klasat e larta dhe mungesa e mbështetjes gjatë kalimit në mësimdhënien në gjuhën maqedonase.

Gjetja 5:

Rekomandime për forcimin e zbatimit të masave për realizimin e së drejtës për arsimim në gjuhën amtare

Pavarësisht shprehjes së mungesës së besimit në kapacitetet e sistemit për të ofruar mundësi të barabarta për arsim cilësor për çdo fëmijë, rekomandimet e prindërve për zbatimin e masave i referohen forcimit të kapaciteteve në sistemin arsimor për të siguruar arsim cilësor në gjuhën e bashkësive më të vogla në vend. Për këtë qëllim, ata e konsiderojnë të nevojshme përfshirjen e të gjithë aktorëve: prindërit, shkollat, bashkësia lokale dhe institucionet përkatëse, si Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Byroja për Zhvillimin e Arsimit dhe Drejtoria për Zhvillimin dhe Avancimin e Arsimit në Gjuhët e Pjesëtarëve të Bashkësive, si dhe mediat.

Duhet të krijohet një program mësimor, të sigurohet kuadër i kualifikuar dhe tekste cilësore, por edhe të punohet për përmirësimin e kushteve fizike në shkolla.

Prindërit theksojnë se është thelbësore që lënda zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive të bëhet e rregullt dhe të zbatohet brenda orarit të shkollës për të siguruar që edhe fëmijët nga zonat e largëta të mund ta ndjekin atë dhe të kenë transport pas orëve.

Rekomandohet mësimi i gjuhës maqedonase paralelisht me gjuhën amtare, duke filluar nga klasa e parë, për të siguruar kushte të drejta për përparimin e çdo fëmije.

Për të krijuar kuadër të kualifikuar mësimor, propozohet hapja e departamenteve për gjuhët e bashkësive më të vogla.

Shkollat synojnë të gjejnë mënyra të arsimit në gjuhën amtare që nuk do të nxisin ndarjen midis bashkësive. Ata besojnë se me një analizë të duhur mund të propozohen zgjidhje të mira. Propozojnë zhvillimin e një strategjie që do të japë drejtimin e zbatimit.

Rekomandimet e nxjerra nga Forumi Pjesëmarrës tregojnë se si institucionet arsimore, ashtu edhe organizatat e shoqërisë civile identifikojnë të njëjtat pengesa dhe dobësi në realizimin e të drejtës për arsimim në gjuhën amtare për bashkësitë më të vogla në vend. Rekomandimet e tyre janë në të njëjtin drejtim me rekomandimet e prindërve dhe përfaqësuesve të shkollave.

KONKLUZIONE

Të drejtën për arsimim në gjuhën amtare nuk mund ta ushtrojnë një numër i madh i fëmijëve nga bashkësitë më të vogla në vend, veçanërisht fëmijët nga bashkësia vllahe dhe rome. Institucionet përgjegjëse nuk arrijnë të sigurojnë kushtet e nevojshme për zbatimin e dy masave për arsimim në gjuhën amtare: 1) mësimin në gjuhët e bashkësive më të vogla dhe 2) lëndën zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive. Mungon një qasje gjithëpërfshirëse që do të mundësojë arsim cilësor në gjuhën amtare që do t'i përgatisë fëmijët për nivelet e ardhshme të arsimit dhe për përfshirjen në shoqëri si të rritur.

Më konkretisht, me analizën e gjendjes së arsimit në gjuhët e bashkësive më të vogla në vend, u arritën këto konkluzion:

1. Mësimi i gjuhës amtare zhvillohet vetëm në një numër të vogël shkollash në zonat ku ka banorë nga bashkësia boshnjake, serbe dhe turke, ndërsa **mësimi i gjuhës vllahe dhe rome nuk zhvillohet në asnjë nivel arsimor.** Prindërit e bashkësive janë të njohur me të drejtën e arsimit në gjuhën amtare, por atyre u mungon informimi adekuat dhe në kohë nga ana e shkollave për masat që mundësojnë praktikimin e saj. Qëndrimi dominues i prindërve nga të gjitha bashkësitë në lidhje me mësimin e gjuhës amtare është mjaft pozitiv dhe mbështetës, por edhe i shoqëruar me shqetësim për arritjet e fëmijëve gjatë kalimit në nivelet më të larta të arsimit ku mësimi në gjuhën amtare nuk ofrohet. Fëmijët nga bashkësitë më të vogla nuk mbështeten në ecurinë e tyre gjatë procesit arsimor në mënyrë që të mund të realizojnë plotësisht potencialin e tyre në mënyrë të sigurt dhe pa probleme. Nëse e fillojnë arsimimin në gjuhën amtare, hasin në sfida të mëdha në mirëmbajtjen e suksesit të tyre kur kalojnë në mësimdhënien në gjuhën maqedonase. Nga ana tjetër, kur prindërit nuk zgjedhin arsimimin në gjuhën amtare për fëmijën e tyre, rrezikojnë që në fillim që fëmija të ketë vështirësi në shprehjen dhe përshtatjen me mjedisin shkollor. Në të dyja rastet, institucionet arsimore nuk e përmbushin rolin e tyre si bartës të përgjegjësisë për realizimin e të drejtës për arsim cilësor për çdo fëmijë, sepse nuk ofrojnë mbështetjen e nevojshme dhe kushtet optimale për përparimin e atyre fëmijëve, gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuha mësimore.

2. Lënda zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive zbatohet në një numër të vogël shkollash në mjediset ku ka banorë nga bashkësitë më të vogla. Prindërit nga të gjitha bashkësitë janë shumë të interesuar që fëmijët e tyre ta

mësojnë këtë lëndë, por mungesa e informacionit për këtë mundësi dhe zbatimi joadekuat i anketës për të shprehur interesim paraqet një kërcënim serioz për zbatimin e masës për realizimin e së drejtës për arsim në gjuhën amtare. Në disa shkolla mungon vullneti nga ana e drejtuesve të shkollës për organizimin e mësimin në këtë lëndë dhe të punësuarit nuk janë të njohur me mundësinë e të mësuarit dhe mënyrën e zbatimit të saj. Ekziston mosbesim i prindërve edhe për cilësinë e mësimdhënies, për shkak të kuadrit joadekuat dhe mungesës së përgatitjes së shkollave për zbatimin e lëndës zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive.

Një barrë shtesë për fëmijët është fakti që kjo lëndë ofrohet si lëndë e dytë zgjedhore, e cila është jashtë planprogramit dhe kërkon angazhimin për të ndjekur më shumë orë nga sa janë planifikuar.

Lënda zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive nuk ofrohet si opsion për fëmijët që u përkasin bashkësive të tjera, megjithëse kjo do të ishte në frymën e Strategjisë “*Një shoqëri dhe interkulturalizëm*” dhe do të kontribuonte në përfshirje, në vend të ndarjes së nxënësve.

3. Përfitimi më i madh i mësimin të gjuhës amtare shihet në mundësinë që fëmijët të shprehin lirshëm dhe të arrijnë rezultate më të mira në mësim.

Ky mendim mbështetet nga përvoja e fëmijëve të bashkësisë turke, suksesi i të cilëve bie me kalimin nga klasa e pestë në të gjashtën, për shkak të ndryshimit të gjuhës mësimore. Një përfitim tjetër i mësimin të gjuhës amtare është mundësia për të përmirësuar gjuhën amtare letrare dhe për të ushqyer kulturën amtare. Për më tepër, edukimi në gjuhën amtare i lejon fëmijët të vazhdojnë arsimimin e tyre në vendet ku flitet ajo gjuhë.

4. Pengesat për zbatimin e masave për arsimin në gjuhën amtare janë të shumta dhe të karakterit sistematik.

Janë evidentuar faktorët e mëposhtëm: mungesa e kuadrit mësimor cilësor dhe kompetent, kriteret e paqarta për përzgjedhjen e kuadrit mësimdhënës, mundësitë e pamjaftueshme për zhvillim profesional të kuadrit mësimdhënës, mungesa e teksteve dhe materialeve mësimore, si dhe mungesa e vullnetit nga ana e drejtorisë së shkollës të zbatojë masat për arritjen e të drejtës për arsimim në gjuhën amtare.

Lënda zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive nuk ka status të barabartë në raport me lëndët e tjera zgjedhore, sepse ofrohet si lëndë e dytë zgjedhore,

që është një sfidë tjetër për zgjedhjen e kësaj lënde. Kjo është veçanërisht një pengesë për fëmijët që jetojnë në zona më të largëta dhe përdorin transport të organizuar për në shkollë, i cili nuk është i disponueshëm pas orëve, jashtë orarit të shkollës.

Numri minimal i paraparë prej 15 nxënësve për formimin e grupit për lëndën zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive në shumë raste nuk mund të arrihet, gjë që bëhet pengesë për zbatimin e saj. Për shembull, kjo është një nga arsytet që në 20 vjetët e fundit nuk është miratuar formimi i grupeve për lëndën zgjedhore Gjuha dhe kultura e vllahëve në shkollat e zonave ku është i pranishëm bashkësia vllahe.

Fëmijët dhe prindërit e bashkësisë rome përfjetojnë pengesa shtesë në realizimin e të drejtës së tyre për arsimim në gjuhën amtare për shkak të diskriminimit të tyre në shoqërinë tonë. Prindërit preferojnë që fëmijët e tyre të mësojnë në gjuhën maqedonase në mënyrë që të integrohen më lehtë dhe më sigurt në shoqëri.

Një pengesë tjetër është mungesa e interesit të prindërve, për shkak të shqetësimit se fëmijët e tyre nuk do të mund të kenë sukses në shkollë të mesme dhe më lartë për shkak të njohjes së pamjaftueshme të gjuhës maqedonase. Për shembull, fëmijët e bashkësisë turke, të cilët mësojnë në gjuhën turke deri në klasën e pestë, nuk janë të përgatitur kalojnë në klasën e gjashtë, atëherë kur mësimi zhvillohet në gjuhën maqedonase. Për shkak të mungesës së njohjes së gjuhës së re të mësimdhënies, sukcesi i tyre bie në mënyrë të theksuar. Në këtë mënyrë, fëmijët privohen nga e drejta për arsim cilësor, ngaqë mësojnë në një mjedis të pafavorshëm për zhvillimin e potencialit të tyre.

REKOMANDIME

Rekomandimet për ushtrimin e së drejtës për arsimim në gjuhën amtare të pjesëtarëve të bashkësive pakicë kanë për qëllim përmirësimin sistematik të kushteve për zbatimin e dy masave për arsimimin në gjuhën amtare: 1) mësimi në gjuhët e bashkësive më të vogla dhe 2) lënda zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive. Më konkretisht, ato mbulojnë aspektet e mëposhtme:

- 1. Të përforcohet dialogu dhe bashkëpunimi ndërmjet të gjitha institucioneve përkatëse dhe Drejtorisë me qëllim të avancimit të arsimit në gjuhët e bashkësive më të vogla.**

2. **Të ofrohet mbështetje sistematike për shkollat në zonat ku ka një popullsi të bashkësive më të vogla në mënyrë që të sigurohet mësimi në gjuhën amtare.** Kjo nënkupton krijimin e programeve të përshtatshme mësimore, sigurimin e personelit të kualifikuar mësimdhënës dhe proceseve transparente për përzgjedhjen e tyre, krijimin, përshtatjen dhe përkthimin e materialeve mësimore dhe teksteve shkollore në secilën nga gjuhët e bashkësive më të vogla. Në të njëjtën kohë, duhet të përmirësohen kushtet fizike në shkollat rajonale ku zhvillohet mësimi në gjuhët e bashkësive më të vogla.
3. **Të rishikohet kriteri që të paktën 15 fëmijë të formojnë një grup** për mësimin e lëndës zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive, në mënyrë që të mundësohet që çdo fëmijë që ka shfaqur interes të jetë në gjendje ta ndjekë atë.
4. **Të rishikohet Ligji për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë** për t'i mundësuar kuadrit mësimor, që zhvillon lëndën zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive, ta realizojë të drejtën për të dhënë provimin për praktikantë, të marrë vendim për marrëdhënie pune të përhershme dhe kriteri për përvojë pune të ndryshohet në të paktën pesë vjet.
5. **Të rishikohet Ligji për tekstet shkollore në seksionin për komisionin recensues dhe autorët e teksteve shkollore,** i cili do t'u mundësojë recensentëve dhe autorëve të teksteve me më pak se 10 vjet përvojë të konkurrojnë në konkurset për tekste dhe recensentë të shpallur nga MASH.
6. **Të hapen lektorate për gjuhët e bashkësive më të vogla në Fakultetin Filologjik në UKIM** me qëllim të përgatitjes së kuadrit mësimor profesional për gjuhën përkatëse. Për shembull, Marrëveshja ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bosnjës dhe Hercegovinës parashikon hapjen e një lektorati për gjuhën boshnjake.
7. **Të ofrohen mundësi për zhvillimin profesional të personelit mësimor** për mësimdhënien në gjuhët e bashkësive më të vogla dhe lëndën zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive, me qëllim ngritjen e cilësisë së mësimdhënies në një nivel më të lartë dhe përforcimin e kompetencave gjuhësore të kuadrit mësimor.
8. **Të ofrohet mbështetje për fëmijët të cilët nga klasa e pestë kalojnë nga mësimi në gjuhën amtare në mësimin në gjuhën maqedonase p.sh., duke**

siguruar një mësimdhënës në gjuhën e tyre amtare i cili do t'i ndihmojë ata të kuptojnë materialin, si dhe nëpërmjet mësimit të gjuhës maqedonase nga klasa e parë deri në klasën e pestë kur mësimi i rregullt zhvillohet në gjuhën amtare.

- 9. Të shqyrtohen qasje të ndryshme për edukimin në gjuhën amtare që mundësojnë cilësi, vazhdimësi dhe integrim në vend të segregimit të fëmijëve nga bashkësitë e ndryshme.** Një model pozitiv në vendin tonë që ekziston prej 25 vjetësh është qasja MOZAIK - grupe dygjuhësore në kopshte që mundësojnë një proces edukativ në dy gjuhët dominuese e mjedisit ku ndodhet kopshti. Në vendin tonë ekzistojnë grupe gjuhësore maqedonase dhe shqipe, maqedonase dhe serbe dhe maqedonase e turke. Një model tjetër i mësimdhënies dygjuhësore në arsimin fillor në gjuhën maqedonase dhe shqipe është qasja e Qendrës për Dialog Nansen për arsim të integruar dhe ndërkulturor. Gjithashtu, mund të përmendim edhe projektin për Fuqizimin e bashkëpunimit ndëretnik në komuna, përmes të cilit Fondacioni i Fëmijëve Pestalloci realizoi mësim të përbashkëta në shkollat fillore të nëntë komunave. Sa i përket arsimit të mesëm, nga viti 2018, tetë shkolla të mesme në Shkup e zhvillojnë me sukses mësimin e rregullt në lëndë të caktuara në dy gjuhë mësimore. Kjo iniciativë zbatohet nga Qyteti i Shkupit dhe mbështetet nga Misioni i OSBE-së në Shkup. Këta janë disa shembuj që mund të konsultohen për të gjetur modele të përshtatshme për arsim cilësor në gjuhën amtare të çdo fëmije në vend.
- 10. Prindërit duhet të informohen me kohë për mundësinë që fëmija i tyre të ndjekë arsimin në gjuhën amtare.** Kryerja e një ankete transparente dhe në kohë në shkolla për të gjithë prindërit, që të mund të shprehin interesin për lëndën zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive. Të organizohen aktivitete për ndërgjegjësimin e prindërve për të drejtën e arsimit në gjuhën amtare në nivel lokal, në bashkëpunim me shkollave dhe vetëqeverisjes lokale, mediave, shoqërisë civile dhe sektorit privat.
- 11. Të sigurohet transport për studentët që jetojnë në vende më të largëta dhe duan të ndjekin lëndën zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive.**
- 12. Të përgatitet një dokument me masa afirmuese për bashkësinë vllahe, identiteti gjuhësor dhe kulturor i të cilës rrezikohet të zhduket.** Qeveria e RMV-së dhe institucionet përkatëse duhet të zbatojnë një proces

për rigjallërimin e gjuhës dhe kulturës vllahe, të fokusuar në tre fusha themelore: arsim, kulturë dhe media

- 13. Të formohet një ekip autorësh për hartimin e teksteve shkollore për lëndën zgjedhore Gjuha dhe kultura e romëve** nën drejtimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe në bashkëpunim me mësime të tjerë që japin lëndën zgjedhore dhe profesorët e Institutit të Pedagogjisë dhe Fakultetit Filologjik në UKIM.
- 14. Në nivel shkollor dhe lokal duhet të zhvillohen aktivitete për integrim ndëretnik** me qëllim të reduktimit të stereotipave, paragjytimeve dhe diskriminimit ndaj pjesëtarëve të bashkësisë rome.
- 15. Të përmirësohet bashkëpunimi me vetëqeverisjen lokale dhe kryetarët e komunave për të investuar në ndërtesat e shkollave dhe për të përmirësuar kushtet e mësimit** në shumë nga shkollat rajonale.

SHTOJCA 1. REZULTATET E HULUMTIMIT MBI GJUHËN BOSHNJAKE NË ARSIM

Mostra

Pyetësorit për prindër iu përgjigjën **149 prindër** nga disa vende të shtetit (Batincë, Konjar i Poshtëm, Konjar i Mesëm, Çento, Ljubosh, Aerodrom, Çair, Petrovec, Shtip, Shkup, Cërkvino, Rzhaniçino), të cilët deklaruan se fëmija i tyre i përket bashkësisë boshnjake. Prej tyre, shumica janë nëna (138; 92%), të moshës 31-40 vjeç (81; 54%), me arsim të mesëm (86; 58%).




Figura 1. Mosha e prindërve




Figura 2. Arsimi i prindërve

Pothuajse të gjithë kanë një fëmijë që është nxënës në shkollë fillore (143; 96% nga 149), ndërsa 46 (31%) nga prindërit kanë një fëmijë në shkollë të mesme (disa prej tyre kanë një fëmijë në shkollë fillore dhe një tjetër në shkollë të mesme). Shumica prej tyre (122; 82%) deklaruan se në shtëpi flasin vetëm boshnjakisht dhe 22 (15%) deklaruan se flasin një nga gjuhët e tjera vendase

përveç boshnjakishtes, që do të thotë se pesë prindërit e mbetur deklaruan se në shtëpi nuk flasin boshnjakisht.




Figura 3. Niveli arsimor i fëmijës




Figura 4. Gjuha që flasin në shtëpi

Në fokus grupe morën pjesë 14 prindër dhe 8 përfaqësues nga mësimdhënësit dhe shërbimi profesional i shkollave.

REZULTATET

Zbatimi i mëimit në gjuhën boshnjake

Pyetësor për prindërit

Shumica e prindërve që iu përgjigjën pyetësorit (132; 89%) raportuan se janë të njohur me të drejtën për arsimim në gjuhën amtare të garantuar me ligjet tona. Megjithatë, vetëm gjysma e tyre ishin të informuar për mundësinë e mëimit në gjuhën amtare nga shkolla (73; 49%) dhe kopshti (2; 1%), ndërsa gjysma tjetër ose nuk ishin informuar (52; 35%) ose nuk e dinin nëse ishin informuar apo jo (22; 15%).




Figura 5. Njohja me të drejtën e arsimit në gjuhën amtare




Figura 6. Informimi për mundësinë e mësimit të gjuhës amtare

Një e treta e prindërve (46; 31%) janë përgjigjur se fëmijët e tyre nuk e mësojnë fare gjuhën boshnjake në shkollë apo në kopsht. Një numër shumë i vogël (3; 2%) deklaruan se fëmijët shkojnë në një kopsht dygjuhësor, dhe 16% (24) mësojnë në gjuhën boshnjake në shkollën fillore. (Figura 7).

Kur u pyetën se sa pajtohen me deklaratën: *“Dua që fëmija im të mësojë në gjuhën amtare”*, në një shkallë nga 1 - aspak nuk pajtohem deri në 10 - plotësisht pajtohem, prindërit janë përgjigjur: 40 (27%) prej tyre zgjodhën shkallën më të ulët të pajtimit (1), 68 (46%) zgjodhën më të lartën (10), ndërsa shkalla mesatare e pajtimit është 6. (Tabela 2).

Fokus grupi me prindërit

Gjatë diskutimit në fokus grupin e prindërve, u konstatua se të gjithë flasin gjuhën boshnjake në shtëpi, përveç familjeve me martesë të përziera, pra ku përveç gjuhës boshnjake flitet edhe gjuha e njërit prind, në këtë rast gjuha shqipe. Shumica e prindërve ishin të njohur me rregulloret ligjore, pra të drejtën për arsimim në gjuhën amtare, por të gjithë u pajtuan me përfundimin se zbatimi i vendimeve ligjore has në pengesa: *“Dikush diku e frenon punën, por nuk e dimë se ku”*.

Të gjithë prindërit deklaruan se fëmijët e tyre mësojnë në gjuhën maqedonase, përveç dy që thanë se fëmijët e tyre, që shkojnë në arsim parashkollor, ndjekin mësimin në gjuhën boshnjake. Pothuajse të gjithë ishin kategorikë në kërkesën e tyre për të mundësuar mësimin në gjuhën boshnjake.

Lidhur me pyetjet “A ekziston mundësia që në kopshtin apo shkollën ku është regjistruar fëmija juaj të ndjek mësimin në gjuhën amtare? Si morët vesh për këtë mundësi dhe nëse nuk ekziston, a e dini se pse?”, dy nga prindërit deklaruan se fëmijët e tyre shkojnë në kopsht në gjuhën boshnjake, janë të kënaqur dhe fëmijët e flasin më mirë gjuhën letrare boshnjake.

Prindërit ishin të ndarë rreth mendimit nëse fëmijët e tyre duhet të mësojnë në gjuhën boshnjake si gjuhë mësimore. Shumica e tyre preferojnë që ajo të mos jetë lëndë zgjedhore por e detyrueshme, në vend që të gjitha lëndët të jenë në gjuhën boshnjake. Qëndrimi i përgjithshëm i prindërve është se ekziston problem me ndjekjen e mësimave në gjuhën maqedonase, të cilën fëmijët e perceptojnë si gjuhë të huaj dhe e kanë të vështirë të përballen me “gjuhën e re”. Në mesin e prindërve mbizotëron mendimi se në shkolla ekziston “droja” se nëse lejohet mësimi i gjuhës boshnjake, shumë mësimdhënës mund të humbasin punën dhe sipas mendimit të tyre, kushti për të ligjëruar në gjuhën boshnjake është që mësimdhënësi të jetë boshnjak.

Fokus grupi përfaqësues nga shkollat

Në diskutimin e fokus grupit me përfaqësues nga shkollat, pjesëmarrësit raportuan se mësimi i gjuhës boshnjake zhvillohet vetëm në njërin nga shkollat e përfshira, nga klasa e parë deri në klasën e nëntë dhe në një tjetër, nga klasa e parë deri në të pestën. Në shkollat e tjera mësimi zhvillohet në gjuhën maqedonase ose shqipe dhe zbatohet lënda zgjedhore Gjuha dhe kultura e boshnjakëve.

“Në shkollën tonë mësimi nga klasa e parë deri në të tretën zhvillohet në gjuhën mësimore boshnjake dhe nga klasa e katërt deri në të nëntën në gjuhën boshnjake, programi eksperimental.” - Deklaratë nga përfaqësuesit e një shkolle në një fshat me mbi 95% boshnjakë.

Edhe në shkollat e dominuara nga popullata boshnjake, gjuha boshnjake shpesh nuk mësohet sepse nuk ka kuadër - shpesh mësimdhënësit nuk marrin përsipër të japin mësim në gjuhën boshnjake sepse nuk kanë programin dhe

literaturën e duhur, ndaj duhet të bëjnë një përpjekje shtesë për ta siguruar atë. Por ka edhe prindër që duan t'i regjistrojnë fëmijët e tyre për të mësuar në gjuhën maqedonase.

“Në 2018 u fut si e rregullt, para asaj ishte eksperimentale. Tekstet shkollore nga klasa e parë deri në të pestën janë në gjuhën boshnjake, po ashtu ka edhe planprograme. Nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë punohet sipas programit të vjetër. Për tekstet shkollore ia bëjmë disi. Përdoren edhe tekste shkollore në gjuhën serbe. Kjo ende nuk është zgjidhur dhe vazhdon të jetë problem.”

Kur u pyetën pse mësimet nuk zhvillohen në gjuhën boshnjake, përfaqësuesit e shkollës përmendën arsyet e mëposhtme: përbërja e përzier e nxënësve nga disa bashkësi, mungesa e kuadrit, e programeve dhe teksteve shkollore, dhe nganjëherë është zgjedhja e prindërve që fëmijët e tyre të ndjekin mësimet në gjuhën maqedonase.

“Nuk ka kuadër, nuk ka programe të përshtatshme, dhe nganjëherë prindërit duan që fëmijët të mësojnë në gjuhën maqedonase. Ata zakonisht kënaqen vetëm me lëndën zgjedhore dhe ndonjëherë as nuk e zgjedhin sepse mendojnë se nuk kanë nevojë për të.”

Zbatimi i lëndës zgjedhore Gjuha dhe kultura e boshnjakëve

Pyetësor për prindërit

Gjysma e prindërve (74; 50%) deklaruan se fëmija i tyre ndjek lëndën zgjedhore Gjuha dhe kultura e boshnjakëve.




Figura 7. Zbatimi i masave në mësimdhënie për mësimin e gjuhës boshnjake

Kur u pyetën për shkallën e pajtimit me deklaratën: *“Dua që fëmija im të mësojë lëndën Gjuha dhe kultura e bashkësisë sonë”* shumica e prindërve u pajtuan plotësisht: 119 (80%) prej tyre zgjedhën shkallën më të lartë të pajtimit (10), 11 (7%) zgjedhën shkallën më të ulët (1), dhe shkalla mesatare e pajtimit ishte 9. (Tabela 2.)

Fokus grupi me prindërit

Në fokus grupin, prindërit e një shkolle ku u krye anketa deklaruan se përkundër numrit të madh të nxënësve që i përkasin bashkësisë boshnjake në shkollë, vetëm dhjetë prej tyre u paraqitën për të mësuar lëndën zgjedhore Gjuha dhe kultura e boshnjakëve, duke mos plotësuar kështu kushtin ligjor për të paktën 15 fëmijë në një paralele.

Pyetjes *“A mësohet lënda Gjuha dhe kultura e boshnjakëve në shkollën ku shkon fëmija juaj? Si morët vesh për atë mundësi?”*, të gjithë pjesëmarrësit që ishin në fokus grup, që ishin prindërit e fëmijëve që ndjekin mësimet në komunën e Qendrës dhe Butelit, thanë se në këto komuna nuk ka lëndë zgjedhore Gjuha dhe kultura e boshnjakëve. U bënë disa herë përpjekje për formimin e një grupi/klase, por pa sukses. Anketat bëhen shpesh në muajin qershor, prindërit nuk janë fare të informuar dhe shkollat nuk tregojnë fort interes për t'i motivuar.

Fokus grupi me përfaqësues nga shkollat

Nga pjesëmarrësit në fokus grupin e përbërë nga përfaqësues të shkollave, fitohet përshtypja se prindërit janë informuar nga shkollat përkatëse dhe se grupet janë duke u formuar. Ata besojnë se përgjegjësinë për këtë e ka menaxhmenti i shkollës, sepse ai nxit formimin e grupeve për lëndët zgjedhore. Nga ana tjetër, ata besojnë se ka shkolla ku drejtoria e bën të pamundur organizimin e një lënde zgjedhore, duke u justifikuar me rregullin se duhet të ketë 15 fëmijë për të bërë një klasë. Këtë gjë prindërit e konsiderojnë të pasaktë dhe se në vende të ndryshme organizohet ndryshe. Ata gjithashtu besojnë se prindërit nuk e zgjedhin këtë për fëmijët e tyre për shkak të kuadrit të përzgjedhur dhe të propozuar në mënyrë joadekuate.

“Ka një përbërje të përzier nxënësish (romë, vllah...), prandaj mësimi nuk mund të jetë tërësisht boshnjakisht. Është në rregull mundësia që të mësohet si lëndë zgjedhore, por kemi një problem tjetër, nuk jemi mjaftueshëm të organizuar dhe nuk e shfrytëzojmë atë që na e ka dhënë shteti. Kam hasur në një problem ku

një prind reagon - ç'më duhet boshnjakishtja, ky është një problem që shfaqet më së shumti në zonat urbane."

"Kemi një lëndë zgjedhore. Kemi të njëjtat probleme – vështirësi bazike dhe keqkuptime nga ana e të rriturve. Arsyetohen se fëmijët do të stërngarkohen."

Informohen nëpërmjet një pyetësi, u jepet fëmijëve për t'ua dhënë prindërve, prindi vendos dhe kështu krijohet një grup. *"Problemi ynë është se kjo lëndë nuk është futur si e rregullt, si anglishtja."*

"Në shkollën tonë 90% e prindërve zgjedhin këtë lëndë, por në shkollat e tjera e di që nuk është kështu sepse prindërit nuk kanë besim te mësimdhënësit. Ata besojnë se nuk ka kuadër të përshtatshëm për këtë gjë, dhe është e vërtetë, shumë pak kanë mbaruar një fakultet të përshtatshëm. Ne kemi mësuar nëpër disa kurse e gjëra të tilla... prandaj, duhet të na lejohet të përfundojmë siç duhet formimin tonë që të mund të japim mësim. Është e nevojshme që të formojmë dhe edukojmë një kuadër të përshtatshëm që të mund të punohet në mënyrën e duhur."

Përfitimet nga zbatimi i masave

Pyetësi për prindërit

Sa i përket pyetjes se sa pajtohen me pohimin: *"Mendoj se fëmija do të përparojë më mirë në shkollë nëse mëson në gjuhën amtare"* prindërit janë të ndarë: 49 (33%) prej tyre zgjedhën shkallën më të ulët të pajtimit (1), 57 (38%) zgjedhën më të lartën (10), ndërsa shkalla mesatare e pajtimit është 6. Ata më së paku pajtohen me pohimin se mësimi në gjuhët e pjesëtarëve të bashkësive është me cilësi më të ulët sesa mësimi në gjuhën maqedonase (69 (46%) kanë zgjedhur shkallën më të ulët të pajtimit (1), 35 (23%) kanë zgjedhur më të lartën (10), ndërsa shkalla mesatare e pajtimit është 4). (Tabela 2.)

(Tabela 2.) Qëndrimet e prindërve për edukimin në gjuhën amtare

Ju lutemi tregoni në një shkallë prej 1-10 (1-nuk pajtohem aspak; 10-pajtohem plotësisht) se sa pajtoheni me pohimet e mëposhtme (vlerat mesatare për grupin):	Vlera mesatare
Dua që fëmija im të mësojë në gjuhën amtare	6
Dua që fëmija im të mësojë lëndën Gjuha dhe kultura e bashkësisë sonë	9
Besoj se një fëmijë do të përparojë më mirë në shkollë nëse mëson në gjuhën amtare.	6
Besoj se mësimi në gjuhët e pjesëtarëve të bashkësive është më pak cilësor sesa mësimi në gjuhën maqedonase.	4

Fokus grupi me prindërit

Duke pasur parasysh se që nga viti 2018 gjuha boshnjake është gjuha e pestë mësimore, në fokus grupin me prindërit u diskutua rreth përfitimeve nga mësimi në gjuhën amtare. Mirëpo, në grup nuk kishte prindër të fëmijëve që ndjekin mësimin në gjuhën boshnjake, përveçse në arsimin parashkollor, ku ishin të kënaqur që fëmija i tyre mëson në gjuhën amtare. Përshtypja e përgjithshme është se prindërit nuk janë shumë të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies në disa shkolla, ndaj vendosin t'i transferojnë fëmijët e tyre në shkolla të tjera, pavarësisht se gjuha boshnjake aty mësohet vetëm si lëndë zgjedhore Gjuha dhe kultura e boshnjakëve. Megjithatë, tek disa prindër mbizotëron mendimi se fëmijët duhet të arsimohen në gjuhën amtare.

Fokus grupi me përfaqësues nga shkollat

Të gjithë përfaqësuesit e shkollave u pajtuan se ekziston frika tek prindërit se nëse fëmijët e tyre mësojnë në gjuhën boshnjake, do të kenë probleme me gjuhën në shkollën e mesme. Mësuesja e cila punon në një shkollë ku gjuha mësimore është gjuha boshnjake thotë se fëmijët, si dhe vetë ata (mësimdhënësit) që vetë kanë mësuar në gjuhën serbo-kroate, nuk kanë asnjë problem në shkollën e mesme. Avantazhi i mundësisë për të mësuar në gjuhën amtare është se fëmijët do të mund të shprehen më lehtë dhe lirshëm në gjuhën e tyre, por edhe do ta flasin më mirë.

“Në fillim ekzistonte frika tek prindërit për atë se si fëmijët e tyre do të vazhdonin më vonë shkollën e mesme, por doli se nuk e kishin fare problem. Ata e zotërojnë maqedonishten pa problem. Prandaj nuk e kuptoj pse prindërit do ta kishin problem ta arsimonin fëmijën në gjuhën e vet. Mendoj se problemi qëndron edhe në faktin se prindërit kanë frikë, ndërsa harrojnë se edhe ne kemi mësuar në serbo-kroatisht dhe nuk kemi pasur asnjë problem”.

“E mësojnë gjuhën, kulturën dhe rrënjët e tyre.”

“Ne shprehemi më mirë në gjuhën tonë, në gjuhën në të cilën mendojmë dhe ëndërrojmë. Kështu kemi fjalor më të madh. Nëse do ta dinin këtë gjë prindërit, të gjithë do ta zgjidhnin këtë mënyrë. Gjuha është identiteti.”

Sa u përket përparësive të mësimi të lëndës zgjedhore Gjuha dhe kultura e boshnjakëve, përfaqësuesit e shkollave konsiderojnë se mësimi i çdo gjuhe është përparësi, veçanërisht i gjuhës amtare. Kështu, nxënësit do të njohin dhe do të mësojnë më shumë informacione për gjuhën dhe kulturën e tyre. Në disa shkolla këtë lëndë e zgjedhin edhe fëmijët e bashkësive të tjera, për shembull maqedonasit. Edhe pse këto janë raste të rralla, ata besojnë se njerëzit që zgjedhin ta bëjnë këtë e bëjnë me vullnetin e tyre të lirë dhe me shumë dashuri.

“Në vendin tonë të gjithë e mësojnë këtë gjuhë zgjedhore, madje edhe maqedonasit e zgjedhin atë sepse jetojnë në një mjedis të tillë. Ndoshta prindërit vërtet nuk i besojnë kuadrit mësimor. Tani kemi tekste, por nuk kemi kuadër adekuat dhe program të klasës së pestë.”

“Dhe nëse nuk e mësojnë kështu (si mësimore ose zgjedhore), nxënësit do të jenë krejtësisht analfabetë sa i përket letërsisë së boshnjakëve.”

Pengesat në zbatimin e masave për arsimim në gjuhën amtare

Pyetësor për prindërit

Një e treta (47; 32%) e prindërve që iu përgjigjën pyetësorit nuk deklaruan arsyet e mundshme për moszbatimin e mësimi të gjuhës boshnjake, duke zgjedhur opsionin “tjetër”, ndërsa një e katërta e prindërve (38; 26%) përgjegjësinë për moszbatimin e mësimi në gjuhën amtare boshnjake e shohin në bashkësinë e

tyre, për të cilin vlerësojnë se kryesisht nuk i intereson kjo mundësi. Numri më i vogël i prindërve (8; 5%) e vendosin përgjegjësinë tek drejtorja e shkollës. Disa prej tyre konsiderojnë se pengesë është mungesa e kuadrit mësimor për lëndët në gjuhën boshnjake (9; 6%), mosekzistenca e teksteve në gjuhën boshnjake (17; 11%), numri i pamjaftueshëm i fëmijëve për të formuar klasë (10; 7%), ndërsa 20 (13%) e prindërve besojnë se është një kombinim i arsyeve të mësipërme.




Figura 9. Arsyet e moszbatimit të mëimit në gjuhën boshnjake (sipas prindërve)

Fokus grupi me prindërit

Në fokus grup, prindërit e dy fëmijëve që shkojnë në kopsht në gjuhën boshnjake theksuan problemin e mungesës së literaturës në gjuhën boshnjake, por pavarësisht kësaj ata do të dëshironin që fëmijët e tyre të vazhdonin shkollimin e mëtutjeshëm në gjuhën boshnjake, duke pasur parasysh se në këtë mënyrë produktiviteti do të jetë më i lartë, por kjo nuk do të thotë se ata duhet të ndahen nga pjesa tjetër e moshatarëve të tyre.

Për prindërit problemi kryesor është shifra prej 15 nxënësve për të formuar një klasë (edhe pse janë mbledhur nënshkrime nga 10 prindër, klasa nuk është formuar). Sipas prindërve, faktori më i madh është shkolla, gjegjësisht drejtorja e shkollës, sepse edhe pse përfaqësimi i boshnjakëve është i lartë, respektivisht një e treta e nxënësve në SHFK “Shën Kirili dhe Metodi” janë pjesëtarë të bashkësisë boshnjake, klasa nuk formohet. Një nga pjesëmarrësit deklaroi se shkolla justifikohet me faktin se nuk ka kuadër për lëndën zgjedhore Gjuha dhe kultura e boshnjakëve.

Ndaj pyetjes “Çfarë mungon dhe si mund të përmirësohet mësimi në gjuhën amtare?” shumica e pjesëmarrësve theksuan mungesën e literaturës dhe

kuadrin joadekuat mësimor, si dhe thanë se në literaturën e gjuhës maqedonase nuk ka elemente të multikulturalizmit.

Sa i përket lëndës zgjedhore Gjuha dhe kultura e boshnjakëve, të gjithë të anketuarit ranë dakord që nuk duhet të vendoset kufi për mësimin e gjuhës si lëndë zgjedhore. Një nga problemet kryesore është informimi joadekuat dhe i pamjaftueshëm i prindërve për këtë mundësi. Është kontestues fakti që të anketuarit vinin në pah se nuk ka kuadër të mjaftueshëm, ndërsa ai ekzistuesi është joadekuat dhe joprofesional.

Fokus grupi me përfaqësues nga shkollat

Si një pengesë të mundshme ata shohin numrin e pamjaftueshëm të mësimitdhënësve për të mbajtur mësim në gjuhën boshnjake. Gjithashtu, e konsiderojnë si mangësi faktin që nuk ka program nga klasa e gjashtë deri në të nëntën. Si mangësie e tretë shohin problemet që fëmijët mund t'i kenë me përdorimin e termave profesionale në gjuhën maqedonase kur regjistrohen në shkollën e mesme. Këtë e neutralizojnë me faktin që mësimitdhënësit gjatë mësim t'ua thonë fjalët profesionale në gjuhën maqedonase, në mënyrë që në të ardhmen ta kenë më e lehtë.

“Mësimitdhënësit duhet ta përmirësojnë gjuhën boshnjake, sepse janë shkolluar në maqedonisht, andaj duhet ta zotërojnë më mirë gjuhën. Kur japim mësim, ne ua themi gjithmonë të gjitha fjalët dhe në maqedonisht [këtu nënkuptojmë termat profesionale] që ata t'i dinë kur të vazhdojnë shkollimin.”

“Problemet në realizimin e mësimitdhënies janë të shumta si: mungesa e teksteve shkollore për mësimin në gjuhën boshnjake; kuadri mësimor që nuk ka njohuri të gjuhës boshnjake; punësimi i kuadrit mësimor pa kontrolluar njohuritë e gjuhës boshnjake; lektyrat në gjuhën maqedonase; ndikimi i pushtetarëve lokalë në punën e shkollës; ndikimi i ngjarjeve politike në nivel lokal dhe qendror në punën e shkollës (Një gjë jepet e shumë ndalohen).

Ata e konsiderojnë sfidë më të madhe faktin se prindërit që nuk janë mjaftueshëm të informuar shpesh vendosin të mos zgjedhin gjuhën boshnjake. Së pari, sepse mendojnë se nuk ka mjaft kuadro profesionale dhe së dyti, sepse mendojnë se gjuha boshnjake në shkollë është ndryshe nga gjuha e folur (dialekti që përdorin). Për përzgjedhjen e kuadrit thonë se kriteret dhe procedurat për punësimin e

mësimdhënësit për këtë lëndë janë të paqarta dhe të parregulluara. Për shembull, një mësimdhënës që ka një diplomë magjistrature në gjuhën boshnjake nuk merr vendim për punësim të përhershëm, ndryshe nga mësimdhënësit e tjerë që japin lëndën Gjuha dhe kultura e boshnjakëve (mësimdhënësit boshnjakë që japin edhe një lëndë tjetër - për shembull fizikën) dhe që marrin vendim.

“Çdo gjuhë është specifike dhe shumë shpesh merr ndikime nga gjuha tjetër që është mbizotëruese në vendin ku jetojmë, por megjithatë ka disa specifika që mësohen në shkollë [një diskutim u zhvillua rreth dialekteve të boshnjakishtes - se çdo zonë ka dialekte], në mësimdhënien mësohet gjuha standarde, jo dialektet.”

Rekomandime për përforcimin e zbatimit të masave për realizimin e të drejtës për arsimim në gjuhën amtare

Pyetësor për prindërit

Prindërit besojnë se duhet të sigurohet kuadër cilësor i cili do të ketë qasje në zhvillimin e vazhdueshëm profesional, tekste shkollore në gjuhën e bashkësisë, program më cilësor mësimor, mundësi për arsimim në gjuhën amtare në të gjitha nivelet arsimore dhe të sigurohet literaturë në gjuhën amtare.

Disa prej tyre propozojnë organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për fëmijët e bashkësive të ndryshme etnike, në mënyrë që të njihen me njëri-tjetrin, të ketë ndërveprim midis fëmijëve.

“Në shkollën fillore të vajzës sime nuk ka mësim për fëmijët e klasave më të të larta, vetëm për të ulëtat, prandaj ajo nuk mund të mësojë lëndën Gjuha dhe kultura e grupit etnik. Edhe pse kishte nxënës që u paraqitën nga klasat më të larta, ata nuk u përfshinë. Akoma nuk kemi marrë një shpjegim. Prandaj besoj se secilit duhet t'i jepet e drejta e garantuar me Ligj dhe jo disa të mund të mësojnë e të tjerë jo. Përveç kësaj, rekomandohet futja e lekturave të reja që korrespondojnë me kohën në të cilën mësojnë fëmijët. Kjo vlen edhe për gjuhën maqedonase, por edhe për gjuhët e tjera të grupeve etnike.

“Program mësimor më cilësor, ndërveprim, shembuj pozitivë të bashkimit të popujve, shmangie e pjesës së errët të historisë, që i bën fëmijët të ndihen ndryshe nga të tjerët.”

“Të ketë më shumë orë, literaturë për mësimin e gjuhës amtare.”

“Kuatër mësimor me cilësi më të lartë dhe tekste shkollore në gjuhën amtare.”

Një pjesë e prindërve konsiderojnë se mësimi duhet të bëhet në gjuhën maqedonase, ndërsa gjuha e bashkësisë të përfaqësohet me nga dy orë në javë. Disa prej tyre besojnë se mësimi i gjuhës amtare duhet të bëhet kryesisht në familje dhe maqedonishten duhet ta mësojnë të gjithë për të kuptuar njëri-tjetrin.

“Kam mësuar në një shkollë maqedonase dhe mendoj se mësimi duhet të vazhdojë në gjuhën maqedonase. Unë dua që fëmijët e mi të flasin gjuhën ku jetojnë, kurse boshnjakishten apo serbishten do t’ua mësojmë në shtëpi.”

Fokus grupi me prindërit

Në diskutimin në fokus grup, prindërit theksuan se për të përmirësuar gjendjen ekzistuese me mësimin e gjuhës boshnjake, është e nevojshme përfshirja e të gjithë pjesëmarrësve në këtë proces, që nënkupton prindërit, autoritetet në shkollë, komunë dhe shtet.

Fokus grupi me përfaqësues nga shkollat

Rekomandimet e dhëna nga përfaqësuesit e shkollave kanë të bëjnë me mësimdhënësit, shkollën, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Byronë për Zhvillimin e Arsimit dhe Drejtorinë për Zhvillimin dhe Avancimin e Arsimit në Gjuhët e Pjesëtarëve të Bashkësive.

Mësimdhënësi ka një rol kyç në mënyrën se si do t’i mësojë nxënësit, nëse do ta bëjë orën argëtuese apo jo.

Shkolla ka përgjegjësinë të organizojë në mënyrë të duhur anketat, miratimet etj. Për shembull, SHFK *“Shën Kirili dhe Metodi”* mund të formojë një grup nëse dëshiron, sepse shumica e nxënësve janë boshnjakë. Një shembull i spikatur ishte një shkollë në të cilën drejtori ka futur vetëm gjuhën boshnjake, të cilën më pas e kanë zgjedhur të gjithë nxënësit. Çdo shkollë duhet të gjejë një mënyrë për t’u organizuar.

“Vendimet varen nga vetëdija e atyre që organizojnë, në shkollën tonë nuk është problem numri i nxënësve, ka grupe edhe me nën 15 nxënës.”

Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) duhet të konsiderojë kufizimin e numrit për formimin e klasës. Gjithashtu, nëse ka një vendim nga ana e tyre, do të ketë më shumë nxënës.

Byroja për Zhvillim të Arsimit (BZHA) duhet të rishikojë programet dhe të sigurojë manuale funksionimi.

Drejtoria duhet të organizojë debate nëpër komuna për të rritur ndërgjegjësimin e prindërve për nevojën e mësimin të gjuhës amtare.

Trajnimi i kuadrit mësimor ekzistues për ligjërimin e gjuhës boshnjake; Sigurimi i teksteve, lekturave dhe literaturës tjetër të nevojshme për mësimdhënie të suksesshme të gjuhës boshnjake në të gjitha klasat; Formimi i vazhdueshëm profesional - përmirësimi i kuadrit mësimor; Ndryshime në ligjet dhe rregulloret lidhur me formimin e grupeve të punës të nxënësve për një lëndë zgjedhore dhe për punësimin e kuadrit mësimor për kryerjen e mësimdhënies në gjuhën mësimore boshnjake ose për ligjërimin e lëndës zgjedhore Gjuha dhe kultura boshnjake.

“Nuk kemi vendim edhe pse kemi shumë vite që punojmë – mendoj se edhe kjo duhet të zgjidhet si problem. Unë dhe kolegja ime kemi një fakultet të përshtatshëm, por nuk kemi vendime për punë, andaj njerëzit kanë frikë ta zgjedhin fakultetin tonë, që është për gjuhën profesionale boshnjake. Kështu na shuhet entuziazmi dhe dëshira për punë.”

“Jemi duke punuar rreth programeve, por nëse kjo procedurë nuk përshejtohet, do të kemi programe, por nuk do të kemi fëmijë, ngaqë grupet po shpërbëhen.”

“Letërsia jugosllave - përfshinte autorë boshnjakë, na jepej mundësia, kemi dhënë provim - ...[u zhvillua një diskutim nëse përpunohet letërsia boshnjake]. Profesori Radiçevski insistoi që të përfshihet në program, por nuk e di nëse është ende aktuale apo jo.”

“Boshnjakët vetë duhet të binden se duhet të mësojnë në gjuhën boshnjake.”

SHTOJCA 2: REZULTATET E HULUMTIMIT MBI GJUHËN VLLAHE NË ARSIM

Mostra

Pyetësorit për prindër iu përgjigjën **89 prindër** nga disa vende të shtetit (disa komuna të Shkupit, Manastirit, Krushevës dhe Shtipit), të cilët deklaruan se fëmija i tyre i përket bashkësisë etnike vllahe. Prej tyre, shumica janë nëna (65; 73%) dhe baballarë (20; 23%), të moshës 31-40 vjeç (38; 43%) dhe 41-50 vjeç (40; 45%), me arsim të lartë 35; 39%), arsim të mesëm (26; 29%) dhe diplomë magjistrature (20; 23%).




Figura 1. Moshë e prindërve




Figura 2. Arsimi i prindërve

Numri më i vogël i prindërve kanë fëmijë në kopsht (18; 20%), shumica kanë fëmijë në shkollë fillore (69; 78%), dhe 13 (15%) prej prindërve kanë fëmijë që shkon në shkollën e mesme (disa kanë një fëmijë në fillore dhe një tjetër në të mesme). Pothuajse numër i barabartë deklaruan se flasin vllahisht dhe një

gjuhë tjetër në shtëpi (42; 47%), se nuk flasin vllahisht (41; 46%), dhe vetëm 6 (7%) thanë se flasin vetëm vllahisht në shtëpi.




Figura 3. Niveli arsimor i fëmijës




Figura 4. Gjuha që flasin në shtëpi

Në fokus grupe morën pjesë 12 prindër, 21 përfaqësues nga mësimdhënësit dhe shërbimi profesional në shkolla, katër përfaqësues nga shërbimi profesional i kopshteve dhe një mësimdhënëse e Gjuhës dhe kulturës vllahe që jep mësim në një grup të formuar në një komunë.

REZULTATET

E drejta për arsimim në gjuhën vllahe

Pyetësor për prindërit

Shumica e prindërve që iu përgjigjën pyetësorit (78; 88%) raportuan se janë të informuar për të drejtën për arsimim në gjuhën amtare të garantuar me ligjet tona. Megjithatë, më pak se gjysma e tyre ishin të informuar për mundësinë e mësimi të gjuhës amtare nga ana e shkollës (34; 38%) dhe kopshtit (1; 1%),

ndërsa shumica ose nuk ishin informuar (34; 38%) ose nuk e dinin nëse ishin informuar apo jo (20; 23%).




Figura 5. Informimi për të drejtën e arsimit në gjuhën amtare




Figura 6. Informimi për mundësinë e mësimi në gjuhën amtare

Ndaj pyetjes se sa pajtohen me pohimin: “Dua që fëmija im të mësojë në gjuhën amtare”, në një shkallë nga 1 - aspak nuk pajtohem deri në 10 - plotësisht pajtohem, shumica e prindërve 48 (54%) kanë zgjedhur shkallën më të lartë të pajtimit (10), ndërsa vetëm 6 (7%) kanë zgjedhur shkallën më të ulët (1), ndërkohë që shkalla mesatare e pajtimit është 8. (Tabela 2.)

Fokus grupi me prindërit

Prindërit raportuan se kjo e drejtë për bashkësinë vllahë nuk ushtrohet në asnjë nivel arsimor. Ata deklaruan se është e nevojshme që të futet mësimi në gjuhën vllahë, së paku pjesërisht, në çdo komunë ku ka popullatë nga bashkësia vllahë, duke filluar nga kopshtet e më tej, në shkollat fillore dhe të mesme. Por ekziston shqetësimi se institucionet ende nuk kanë ofruar kushtet për zbatimin e kësaj kërkesë.

Fokus grupi me përfaqësues nga shkollat

Përfaqësuesit e institucioneve dhanë përshtypjen se nuk ishin mjaftueshëm të informuar për këtë të drejtë. Disa prej tyre thanë se të gjithë nxënësit mësojnë në gjuhën amtare, duke e menduar gjuhën maqedonase dhe shqipe.

Zbatimi i lëndës zgjedhore Gjuha dhe kultura e vllahëve

Pyetësor për prindërit

Vetëm 31 (35%) prindër deklaruan se fëmija i tyre ndjek lëndën zgjedhore Gjuha dhe kultura e vllahëve.

Kur u pyetën për shkallën e pajtimit me pohimin: “Dua që fëmija im të mësojë lëndën Gjuha dhe kultura e bashkësisë sonë” shumica e prindërve u pajtuan plotësisht: 77 (87%) prej tyre zgjedhën shkallën më të lartë të pajtimit (10), vetëm 1 (1%) zgjedhën shkallën më të ulët (1), ndërsa shkalla mesatare e pajtimit është 9. (Tabela 2.)

Fokus grupi me prindërit

Prindërit raportuan se lënda zgjedhore GJKV nuk zbatohet gjithandej dhe aty ku zbatohet, jo të gjithë prindërit janë mjaftueshëm të informuar, veçanërisht ata nga martesat e përziera, fëmijët e të cilëve janë të regjistruar në shkollë si pjesëtarë të një bashkësie tjetër, kështu që nuk u ofrohet fare kjo mundësi për të mësuar gjuhën vllahë, si gjuhë e njërit prind. U theksua se nëpër shkolla nuk ka anketim dhe asnjë lloj promovimi.

“Nuk e dija që ekzistonte mundësia për të pasur një anketë të tillë. Deri më tani nuk kemi pasur anketë që të mund të zbatohet vllahishtja si lëndë, unë e kam çuar njërin nga fëmijët e mi privatisht (tani në klasën e 8-të). Kam dhe një fëmijë tjetër që është klasa e 3-të. Konsideroj se duhet të ketë anketë për të parë se sa fëmijë janë të interesuar dhe mendoj që të gjithë, pavarësisht nëse janë nga një martesë e përzier apo jo, duhet ta kenë mundësinë. Në realitet, gjuha vllahë është një gjuhë që po vdes dhe prandaj mendoj se është e nevojshme të mundësohet.”

“Unë mendoj se duhet të ofrohet si lëndë zgjedhore e rregullt - ndërsa tani është lëndë zgjedhore shtesë. Unë e di se pse është kështu (si lëndë

zgjedhore shtesë), për t'ia plotësuar orët mësimdhënësit të etikës ose një lëndë tjetër zgjedhore në shkollë. Mendoj se duhet të rregullohet me ligj. Në Evropë, kur prindërit kërkojnë një gjuhë shtesë, u jepet mundësia 4-5 fëmijëve ta mësojnë gjuhën e tyre, ndërsa një nga mësimdhënësit e lëndës, që e njej gjuhën, ua ligjëron atë një grupi fëmijësh të moshave të ndryshme.”

Fokus grupi me përfaqësues nga shkollat

Përfaqësuesit e shkollave janë habitur shumë për mundësinë e tillë, duke theksuar se nuk kanë asnjë udhëzim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH). Një pjesë e vogël e të pranishmëve thanë se ishin të njoftuar, por duke qenë se nuk kanë nxënës të deklaruar si vllëh, kjo mundësi nuk iu është ofruar në shkollë me anketa apo në ndonjë mënyrë tjetër.

Në dy shkolla, prej shumë vitesh zbatohet mësimi zgjedhor i gjuhës dhe kulturës vllahe, ku vijnë edhe fëmijë nga shkollat e tjera.

Mësimdhënësja e GJKV-së theksoi se anketimi është obligim ligjor. Për shkak se është një lëndë zgjedhore shtesë dhe është jashtë orarit, nxënësit e regjistruar duhet të kthehen sërish në shkollë në orët e mbrëmjes për të ndjekur lëndën zgjedhore në gjuhën vllahe, zakonisht me orë bllok. Nga ana tjetër, për nxënësit e shkollave të tjera, shpesh shkolla amë nuk e merr parasysh notën në lëndën Gjuha dhe kultura e vllëhëve dhe nuk e përfshin atë në dëftesë.

Sa i përket arsimit parashkollor, pjesëmarrësit deklaruan se deri më tani nuk kanë pasur aktivitete në atë drejtim në kopshte.

“Kam punuar edhe në arsimin e mesëm. Në kopshte nuk ofrohet, sivjet kemi gjashtë fëmijë vllëh dhe nuk e kemi ofruar”, psikologe në kopsht.

“Programet na jepen nga ministritë dhe nuk kemi pasur asnjëherë udhëzime apo projekte për gjuhën vllahe, ndërkaq nuk ka pasur as iniciativë nga prindërit”, përfaqësuese e kopshtit.

Përfitimet nga zbatimi i masave

Pyetësor për prindërit

Sa i përket pyetjes se sa pajtohen me pohimin: “Mendoj se fëmija do të përparojë më mirë në shkollë nëse mëson në gjuhën amtare” prindërit janë të ndarë: 18 (20%) prej tyre zgjedhën shkallën më të ulët të pajtimit (1), 36 (40%) zgjedhën më të lartën (10), ndërsa shkalla mesatare e pajtimit është 6. Ata më së paku pajtohen me pohimin se mësimi i gjuhëve të pjesëtarëve të bashkësive është me cilësi më të ulët se mësimi i gjuhës maqedonase Ç32;(36%) kanë zgjedhur shkallën më të ulët të pajtimit (1), 14 (16%) kanë zgjedhur më e lartën (10), ndërsa shkalla mesatare e pajtimit është 5). (Tabela 2.)

(Tabela 2.) Qëndrime të prindërve për arsimimin në gjuhën amtare

Ju lutemi tregoni në shkallë prej 1-10 (1-nuk pajtohem aspak; 10-pajtohem plotësisht) se sa pajtoheni me pohimet e mëposhtme (vlerat mesatare për grupin):	Vlera mesatare
Dua që fëmija im të mësojë në gjuhën amtare.	8
Dua që fëmija im të mësojë lëndën Gjuha dhe kultura e bashkësisë sonë.	9
Besoj se një fëmijë do të përparojë më mirë në shkollë nëse mëson në gjuhën amtare.	6
Besoj se mësimi në gjuhët e pjesëtarëve të bashkësive është më pak cilësor sesa mësimi në gjuhën maqedonase.	5

Fokus grupi me prindërit

Sipas prindërve është i rëndësishëm mësimi i lëndës zgjedhore Gjuha dhe kultura e vllahëve, sepse për disa fëmijë është kontakti i vetëm me gjuhën. Kjo lëndë është një mundësi e mirë për të kultivuar gjuhën dhe për të siguruar të ardhmen e saj. Më tej, ata theksuan se duke mësuar dy gjuhë paralelisht në moshë të re, fëmijët fitojnë aftësinë për të mësuar lehtësisht gjuhë të tjera, veçanërisht gjuhët romane.

Fokus grupi me përfaqësues nga shkollat

Një mësimdhënës i GJKV-së beson se mësimi i gjuhës vllahe si gjuhë amtare apo si gjuhë e njërit prind është pozitiv edhe për nxënësit që nuk kanë prejardhje vllahe. Kjo duhet të jetë një sfidë përmes së cilës ata të njohin një gjuhë tjetër nga mjedisi i tyre.

“Tani u flasim vetëm gjyshërit, kështu mirëmbahet gjuha që është në zhdukje.”

Pengesat në zbatimin e masave për arsimim në gjuhën amtare

Pyetësor për prindërit

Një e treta (26; 29%) e prindërve që iu përgjigjën pyetësorit nuk japin arsye për moszbatimin e mësimin të gjuhës vllahe, dhe 13 (15%) prindër besojnë se prindërit nga bashkësia nuk janë të interesuar për këtë mundësi. Vetëm një prind (1%) e sheh përgjegjësinë te drejtoria e shkollës. Disa prej tyre konsiderojnë se pengesë paraqet mungesa e kuadrit mësimor (5; 6%), mungesa e teksteve shkollore në gjuhën boshnjake (3; 3%), numri i pamjaftueshëm i fëmijëve për të formuar një paralele (6; 7%), ndërsa 35 (39%) prindër besojnë se është një kombinim i më shumë arsyeve.




Figura 7. Arsye për moszbatimin e mësimin të gjuhës vllahe (sipas prindërve)

Fokus grupi me prindërit

Prindërit raportojnë se nuk janë të informuar për mundësinë që fëmijët e tyre të mësojnë në gjuhën amtare ose të studiojnë lëndën zgjedhore GJKV. Një pengesë tjetër është kërkesa që të paktën 15 nxënës të interesuar të formojnë

një paralele për GJKV, gjë e cila shpesh herë, në vendbanimet më të mëdha nuk mund të sigurohet për shkak të shpërndarjes së nxënësve dhe mungesës së informacionit.

Statusi i lëndës zgjedhore GJKV, e cila ofrohet si lëndë zgjedhore shtesë e jo në të njëjtin nivel me lëndët e tjera, është një pengesë tjetër - dy orë shtesë për fëmijët dhe një mbingarkesë për ta. Mësimet për këtë lëndë nuk organizohen brenda orarit shkollor, nuk ka literaturë profesionale, për shkak të së cilës prindërit ndihen të diskriminuar dhe besojnë se çdo komunë në të cilën ka një numër të caktuar vllahësh duhet të ofrojë kushte adekuate për mësimin e vllahishtes, pa kufizuar numrin dhe përkatësinë e deklaruar. Komuna dhe shkollat së bashku me mësimdhënësit duhet ta promovojnë këtë mundësi.

Fokus grupi me përfaqësues nga shkollat

Si pengesa kryesore për zbatimin e duhur të masës së mësimin të gjuhës amtare si lëndë zgjedhore, pjesëmarrësit i dhanë mungesën e informimit të prindërve, kuadrin e pamjaftueshëm profesional që lidhet ngushtë me mungesën e trajnimit të këtij kuadri dhe mospërfshirjen në trajnimin e rregullt të kuadrit mësimor nga shkollat.

Rekomandime për përforcimin e zbatimit të masave për realizimin e të drejtës për arsimim në gjuhën amtare

Pyetësor për prindërit

Një e treta e prindërve dhanë rekomandime për realizim më të mirë të së drejtës për arsimim në gjuhën amtare, të cilat u referohen këtyre fushave:

- 1) Të rritet numri i kuadrit cilësor mësimor që do të japë mësim në gjuhën vllahe, të investohet në formimin e tyre dhe të ofrohet punësim për kohë të pacaktuar. *“Aftësim i personelit dhe reforma në arsim për programet mësimore të ciklit të parë të studimeve, sepse disa nga gjuhët nuk janë më të disponueshme si opsion për mësim në programin përkatës.”*
- 2) Shkollat fillore dhe të mesme të formojnë paralele të gjuhës vllahe dhe të paktën dy herë në javë të zbatohet lënda Gjuha dhe kultura e vllahëve.

“Çdo bashkësi ta mësojë gjuhën e tij amtare dhe kjo duhet të ndodhë në kopshtin ose shkollën ku mëson fëmija, dhe jo të grupohen fëmijët në një shkollë.”

“Të fillohet me mësimin e gjuhës vllahe sepse tashmë ajo po zhduket. Atë e flasin vetëm gjyshërit dhe kjo është shumë pak që fëmijët ta mësojnë plotësisht dhe saktë.”

- 3) Familjet të flasin gjuhën në shtëpi, me fëmijët që nga mosha më e vogël, për të ruajtur gjuhën dhe traditën.
- 4) Të promovohet më intensivisht mundësia e mësimin të gjuhës amtare, për t'i informuar të gjithë prindërit.
- 5) Në arsimin e rregullt të mësohen kulturat dhe gjuhët e bashkësive të tjera, në mënyrë që të pakësohen paragjykimet për njëri-tjetrin. Të organizohen aktivitete jashtëshkollore për njohjen e fëmijëve nga bashkësi të ndryshme.
- 6) Cilësia e arsimit të përgjithshëm duhet përmirësuar, pavarësisht gjuhës.
“Programe më efikase.”
“Shkollat duhet të përmirësojnë kushtet, të zhvillohet mësim më cilësor dhe më tepër mësim praktik.”
- 7) Të futet një program dygjuhësor në çdo kopsht.

Fokus grupi me prindërit

Pjesëmarrësit e fokus grupit shprehën nevojën për futjen e mësimdhënies, qoftë edhe pjesërisht, në gjuhën vllahe në çdo komunë ku ka prezencë të bashkësisë vllahe, kurse institucionet duhet të ofrojnë kushte si: trajnim i mësimdhënësve të rinj, hartim i literaturës, sigurim i transportit për nxënësit në vende më të mëdha ku ka një shpërndarje më të gjerë të bashkësisë vllahe dhe ku nxënësit nuk mund të përfshihen vetë në mësimin eventual të vllahishtes, ndërsa prindërit nuk mund t'i marrin fëmijët e tyre për shkak të punës.

Prindërit besojnë se është e rëndësishme t'u jepet kjo mundësi të gjithë fëmijëve dhe për të gjitha gjuhët, si dhe se të gjithë mësimdhënësit në shkollë duhet ta promovojnë këtë mundësi dhe t'i inkurajojnë fëmijët ta zgjedhin atë.

Të gjithë prindërit u pajtuan që duhet të bëhet një anketë në të gjitha shkollat, pavarësisht nëse ka apo jo fëmijë vllah të regjistruar apo fëmijë nga bashkësi të

tjera etnike. Në promovimin e lëndës duhet të përfshihen edhe institucionet, të punohet në sigurimin e literaturës së duhur të shkruar dhe video materialeve. Të punohet në sigurimin e kuadrove - përmes futjes së gjuhës vllahe në departament të caktuara (ka pasur një tentativë në fakultetin në Shtip, por pa sukses) ose të mbahen kurse për licencimin e kuadrit mësimit.

Ka pasur sugjerime që të formohen grupe në nivel komunal, por si opcion më pak i dëshirueshëm, ose të sigurohet një mësimdhënës që do të shkonte nga një shkollë në tjetrën.

Të ofrohet si lëndë e rregullt zgjedhore, jo si lëndë zgjedhore shtesë që i ngarkon nxënësit.

Të ketë më shumë mbikëqyrje nga institucionet kompetente, të monitorohet nëse dhe sa bëhet anketa dhe promovimi dhe të vendosen sanksione nëse nuk realizohet.

Prindërit të nisin një iniciativë dhe ta kërkojnë vetë, si dhe të kërkojnë mbështetje nga organizatat ndërkombëtare, shoqatat etj.

MASH të ndërmarrë aktivitete për ndryshime në rregulloret ligjore për ndryshimin e kushtit që të ketë të paktën 15 fëmijë për të formuar grupin për lëndën Gjuha dhe kultura e bashkësive sepse bëhet fjalë për një të drejtë themelore të njeriut - mësimi i gjuhës amtare.

Komunat dhe institucionet arsimore (shkollat dhe kopshtet) - të marrin pjesë në promovimin e kësaj lënde zgjedhore dhe të bëjnë anketim pavarësisht përbërjes etnike të nxënësve.

Shumica e pjesëmarrësve në fokus grupin e parë mendojnë se autoritetet përkatëse duhet të bëjnë ndryshime në rregulloret ligjore për të lehtësuar realizimin e kësaj të drejte - mësimin e gjuhës amtare apo arsim në gjuhën amtare.

“Të gjitha institucionet përkatëse duhet të punojnë për sigurimin e së drejtës kushtetuese për të vepruar, për të pasur një realizim, për të pasur ndikim të përbashkët dhe jo secili t’ia kalojë përgjegjësinë tjetrit.”

“... të organizohen grupe për mësimin e gjuhës vllahe në shkolla dhe në nivel komunal. Kjo është veçanërisht e rëndësishme sepse gjuha vllahe nuk përdoret më as në shtëpi...”

“... të krijohet një program i posaçëm për mirëmbajtjen dhe rigjallërimin e gjuhës vllahe, ku duhet të përfshihen edhe shoqata etj..

“Të fillohet nga kopshtet, megjithëse është problematike, sepse nëse fëmija duhet të dërgohet në një kopsht tjetër pasi nuk ofrohet në secilin, prindërit nuk do të mund ta bëjnë këtë.”

“Të ketë një mësimdhënës që të shkojë nga kopshti në kopsht.”

Fokus grupi me përfaqësues nga shkollat

Shumica e pjesëmarrësve mendojnë se MASH duhet të përgatisë një strategji të mirë organizative për secilën gjuhë veç e veç, sipas nevojave të secilës bashkësi. Strategjia duhet të bazohet në mundësi praktike dhe realiste për zbatim. Të përfshihen mediat për të promovuar strategjinë dhe mundësitë e ofruara, dhe në të njëjtën kohë të ketë trajnime dhe edukim, si për prindërit ashtu edhe për mësimdhënësit. Ka pasur gjithashtu një propozim për përfshirjen e gjuhëve në lëndët tashmë ekzistuese - të mësuarit të kulturës së bashkësive të tjera etnike.

Disa nga të pranishmit theksuan se MASH duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë gjuhës vllahe sepse ajo është në gjendje kritike, dhe ndërkohë duhet të alarmohen edhe mediat dhe prindërit.

Pjesëmarrës të caktuar nga fokus grupi i dytë insistuan në nevojën e një edukimi të tillë për kuadrin mësimdhënës, e më pas për fëmijët dhe të tjerët, sepse siç thanë: *“ne i zbatojmë programet që përfshijnë bashkësitë e tjera etnike.”*

Nga ana tjetër, ka individë që besojnë se ende nuk ka kushte për përgatitjen e programeve të veçanta dhe se mjafton shënimi i festave të bashkësive më të vogla.

SHTOJCA 3: REZULTATET E HULUMTIMIT MBI GJUHËN ROME NË ARSIM

Mostra

Pyetësorit për prindër iu përgjigjën **86 prindër** nga disa vende të shtetit (disa komuna të Shkupit, Kumanovës dhe Shtipit), të cilët deklaruan se fëmija i tyre i përket bashkësisë etnike rome. Prej tyre, shumica janë nëna (58; 67%) dhe baballarë (23; 27%), të moshës 31-40 vjeç (42; 49%) dhe midis 21-30 vjeç (22; 26%), me arsim fillor (41; 48%) dhe arsim të mesëm (32; 37%).




Figura 1. Moshja e prindërve




Figura 2. Arsimi i prindërve

Numri më i madh i prindërve kanë fëmijë në kopsht (68; 79%), 14 (16%) prindër kanë fëmijë në shkollë të mesme (disa kanë një fëmijë në filllore dhe një tjetër në të mesme) dhe 11 (13%) në kopsht. Gjysma e tyre (43; 50%) raportojnë se flasin vetëm gjuhën rome në shtëpi, 27 (31%) raportojnë se flasin një nga gjuhët e tjera lokale përveç gjuhës rome dhe 16 (19%) prindër raportojnë se në shtëpi nuk flasin gjuhën rome.




Figura 3. Niveli arsimor i fëmijës




Figura 4. Gjuha që flasin në shtëpi

Në fokus grupe morën pjesë gjashtë prindër dhe tetë përfaqësues nga mësimdhënësit dhe shërbimi profesional i një shkolle.

REZULTATET

E drejta për arsimim në gjuhën rome

Pyetësor për prindërit

Shumica e prindërve që iu përgjigjën pyetësorit (72; 84%) raportuan se janë të informuar me të drejtën për arsimim në gjuhën amtare të garantuar me ligjet tona. Megjithatë, më pak se gjysma e tyre ishin të informuar për mundësinë e mësimit të gjuhës amtare nga ana e shkollës (36; 42%) dhe kopshtit (1; 1%), ndërsa shumica ose nuk ishin informuar (25; 29%) ose nuk e dinin nëse ishin informuar apo jo (24; 28%).




Figura 5. Njohja me të drejtën për arsimimin në gjuhën amtare




Figura 6. Informimi për mundësinë emësimit në gjuhën amtare

Vetëm një e treta e prindërve shprehin një qëndrim të fortë në lidhje me dëshirën që fëmija i tyre të mësojë në gjuhën amtare. Ndaj pyetjes se sa pajtohen me pohimin: “Dua që fëmija im të mësojë në gjuhën amtare”, në një shkallë nga 1 - aspak nuk pajtohem deri në 10 - plotësisht pajtohem, prindërit janë të ndarë: 30 (35%) prej tyre zgjedhën shkallën më të ulët të pajtimit (1), 26 (30%) zgjedhën më të lartën (10), ndërsa shkalla mesatare e pajtimit është 5. (Tabela 2.)

Fokus grupi me prindërit

Konkluzioni i përgjithshëm është se përveç që flasin gjuhën rome në shtëpi, të gjithë flasin edhe gjuhën maqedonase, diku dominon maqedonishtja, ndërsa diku tjetër gjuha rome.

Fëmijët e të gjitha nënave të pranishme mësojnë në gjuhën maqedonase. Të gjithë kanë fëmijë në shkollë fillore, ndërsa njëra ka edhe në shkollë të mesme. Ato nuk ishin mjaftueshëm të informuara se sipas ligjit fëmijët mund të mësojnë gjuhën rome, gjegjësisht mendojnë se mjafton të flasin gjuhën rome në shtëpi dhe se nuk duhet ta mësojnë atë në shkollë, veçanërisht sepse gjuha rome në shkollë është ndryshe (letrare) nga ajo që flitet në shtëpi.

Fokus grupi me përfaqësues nga shkollat

Në këtë shkollë, prej nga vijmë pjesëmarrësit, mësohet gjuha maqedonase dhe shqipe.

“Dikur ekzistonte edhe gjuha rome - por si lëndë zgjedhore. Kishte edhe një mësimdhënë. Tani nuk ka më.”

Zbatimi i lëndës zgjedhore Gjuha dhe kultura e romëve

Pyetësor për prindërit

Vetëm nëntë prindër (10%) raportuan se fëmija i tyre mëson lëndën zgjedhore Gjuha dhe kultura e romëve (GJKR).

Kur u pyetën për shkallën e pajtimit me pohimin: “Unë dua që fëmija im të mësojë lëndën Gjuha dhe kultura e bashkësisë sonë, gjysma e prindërve u pajtuan plotësisht: 45 (52%) prej tyre zgjodhën shkallën më të lartë të pajtimit (10), 19 (22%) zgjodhën shkallën më të ulët (1), dhe shkalla mesatare e pajtimit është 7). (Tabela 2.)

Fokus grupi me prindërit

Prindërit janë të vetëdijshëm se ekziston mundësia për ta mësuar atë lëndë, por asnjë nga pjesëmarrëset nuk i ka paraqitur fëmijët e tyre. Së pari, për shkak se, nga eksperiencia me gjeneratat e mëparshme ose nga ajo që e mësojnë në Sumnal kanë ardhur në përfundim se kjo nuk është gjuha e njëjtë që flasin në shtëpi. Së dyti, ata mendojnë se gjuha rome që fëmijët dëgjojnë dhe mësojnë në shtëpi mjafton që ata të njohin gjuhën që flitet në këtë zonë. Së treti, i shqetëson fakti që gjuha është përfshirë si lëndë shtesë dhe se është një ngarkesë organizative për fëmijët e tyre që të dëgjojnë një lëndë tjetër jo të detyrueshme.

“Unë mendoj se ka, por fëmija im nuk e ndjek. Ka disa fjalë që ne nuk i përdorim dhe ata i mësojnë atje.”

“Do të kishte qenë shumë e komplikuar, kështu që nuk e lashë. Ne flasim një tjetër gjuhë rome në shtëpi, dhe atje mësohet një tjetër.”

“Mësimdhënësi na informoi se është e mundur, por vetëm pas orëve të mësimt. Ne dimë disa fjalë që ata i kanë mësuar më parë (ata shkojnë në Sumnal) dhe

aty shohim se ajo gjuhë është ndryshe. Një gjë në shtëpi, dhe një gjë tjetër atje.”

“Dimë se mësohet për kulturën. Ajo gjuhë është mirë të mësohet, por është një ngarkesë për fëmijët dhe nuk kuptohet asgjë që thuhet në atë gjuhë (gjuhë letrare).”

Fokus grupi me përfaqësues nga shkollat

Të punësuarit e shkollës raportuan se dikur kishte një lëndë zgjedhore GJKR, por tani kjo nuk ekziston për disa arsye: nuk ka fëmijë të paraqitur, nuk ka kuadër adekuat, nuk ka interes nga prindërit, sepse mësohet si lëndë e dytë zgjedhore dhe fëmijët duhet të vijnë pas orëve. Prindërit besojnë se nuk ka nevojë të mësojnë gjuhën rome, sipas tyre mjafton që ta mësojnë në shtëpi. Ata thonë se janë duke bërë anketa, por nuk paraqiten mjaft fëmijë.

“Prindërit deklarojnë se nuk ka nevojë dhe se dinë gjuhën.”

“Por ata në fakt nuk e dinë, sepse gjuha që ata dinë nuk është letrare.”

“Nuk kishim mësimdhënës adekuat, me siguri prindërit e vënë re dallimin. Kishim një mësimdhënës që ishte i mirë, por ai u largua shpejt. Së dyti, fëmijët kanë një numër të madh orësh dhe kjo për ta është mbingarkesë. Përveç lëndës zgjedhore, ata kanë edhe një tjetër lëndë zgjedhore - gjuhën. Ndoshta për ta duhet të ketë një zgjedhore, jo dy. Ne u lëshojmë anketa të gjithëve dhe për të gjitha gjuhët. Gjithashtu, nuk ka literaturë adekuate. Momentalisht lënda është hequr, por ne po vazhdojmë së zhvilluari anketa për të ditur nëse do ta organizojmë për së dyti. Nëse duan, mund të përfshihen edhe më të mëdhenjtë, nëse tregojnë interes.”

Përfitimet nga zbatimi i masave

Pyetësor për prindërit

Sa i përket pyetjes se sa pajtohen me pohimin: “Mendoj se fëmija do të përparojë më mirë në shkollë nëse mëson në gjuhën amtare” prindërit janë të ndarë: 33 (38%) prej tyre zgjedhën shkallën më të ulët të pajtimit (1), 22 (26%) zgjedhën më të lartën (10), ndërsa shkalla mesatare e pajtimit është 5. Më së

paku pajtohen me pohimin se mësimi në gjuhët të pjesëtarëve të bashkësive është me cilësi më të ulët se mësimi në gjuhën maqedonase (28;(33%) kanë zgjedhur shkallën më të ulët të pajtimit (1), 28 (33%) kanë zgjedhur më e lartën (10), ndërsa shkalla mesatare e pajtimit është 5). (Tabela 2.)

(Tabela 2.) Qëndrime të prindërve për arsimimin në gjuhën amtare

Ju lutemi tregoni në një shkallë nga 1-10 (1-nuk pajtohem aspak; 10-pajtohem plotësisht) se sa pajtoheni me pohimet e mëposhtme (vlerat mesatare për grupin):	Vlera mesatare
Dua që fëmija im të mësojë në gjuhën amtare.	5
Dua që fëmija im të mësojë lëndën Gjuha dhe kultura e bashkësisë sonë.	7
Besoj se një fëmijë do të përparojë më mirë në shkollë nëse mëson në gjuhën amtare.	5
Besoj se mësimi në gjuhët e pjesëtarëve të bashkësive është më pak cilësor sesa mësimi në gjuhën maqedonase.	5

Fokus grupi me prindërit

Prindërit nuk kishin një mendim rreth përfitimeve.

Fokus grupi me përfaqësues nga shkollat

Mësimdhënësit besojnë se është e dobishme që fëmijët e bashkësisë rome të mësojnë lëndën GJKR, për të ushqyer kulturën e tyre si dhe për të mësuar gjuhën letrare rome.

“Është e dobishme për romët. Ata shprehen më lehtë dhe e mësojnë më mirë gramatikiisht.”

“Kultivohen gjuhët e bashkësive etnike. Nga kjo lëndë mësohet edhe kultura e tjetrit.

Pengesat në zbatimin e masave për arsimim në gjuhën amtare

Pyetësor për prindërit

Një e katërta e prindërve (21; 25%) besojnë se prindërit nuk janë të interesuar që fëmijët e tyre të mësojnë në gjuhën rome. Një pjesë e prindërve konsiderojnë se pengesë është mungesa e kuadrit mësimor që do t'i jepte lëndët në gjuhën rome (14; 16%), mungesa e teksteve shkollore në gjuhën rome (8; 9%), numri i pamjaftueshëm i fëmijëve për të formuar klasë (3; 4). % dhe vetëm dy prindër (2%) e vendosin përgjegjësinë tek drejtoria e shkollës. Një në pesë prindër (19; 22%) beson se është një kombinim i arsyeve të mësipërme.

Një numër i barabartë i prindërve (19; 22%) që i janë përgjigjur pyetësorit nuk deklarojnë arsyet e mundshme për moszbatimin e mësimin në gjuhën rome, duke zgjedhur opsionin “tjetër”.




Figura 7. Arsyet për moszbatimin e mësimin në gjuhën rome (sipas prindërve)

Fokus grupi me prindërit

Prindërit besojnë se udhëheqësia e shkollës duhet të mundësojë që GJKR të jetë një lëndë e rregullt që të gjithë fëmijët do ta mësojnë së bashku, pa i ndarë fëmijët e tyre nga grupi. Ekziston një frikë dhe rezervë për mësimin e kësaj lënde sepse ajo nuk përdoret në jetën e përditshme, kur kërkojnë punë apo ndonjë dokument në ndonjë institucion. Prindërit theksuan se përgjithësisht ndihen të diskriminuar dhe kanë frikë të stimulojnë fëmijët e tyre të flasin gjuhën rome në mënyrë që të mos ngacmohen apo injorohen.

“Epo lënda e gjuhës rome ekziston, por si orë shtesë. Nëse do të ishte lëndë e rregullt dy herë në javë, atëherë nuk e kam problem ta çoj. Nëse do të ishte lëndë e rregullt në shkollë do të duhej ta ndjekë..”

“Sikur të ishte anglisht, turqisht ose gjuhë tjetër. Gjuhën rome e mësojnë në shtëpi. Ne të gjithë kemi folur maqedonisht në shtëpi dhe nuk kishim problem. Unë u flas në gjuhën rome.”

“Pse ta mësosh gjuhën amtare? Ata duhet të mësojnë maqedonishten. Ka edhe turq që mësojnë maqedonisht. Është bukur të mësosh gjithçka. Por është më mirë të mësosh maqedonisht. Nëse ai mëson në gjuhën rome për 9 vjet - ku do ta regjistrojmë pastaj, ku do të punojë. Nuk e kemi dhe aq të lehtë të gjejmë punë. Në Shutkë mësimi zhvillohet në maqedonisht, por kanë edhe lëndë të gjuhës rome..”

“Pse ta mësojmë gjuhën rome, pastaj, kur na duhet ndonjë dokument dhe nuk dimë ta kërkojmë, na quajnë jevgj. Madje edhe kur takojmë një rom, ai na flet në maqedonisht. Në punë, më ndalohet të flas në gjuhën rome me miqtë e mi romë.”

“Nuk do të them më shumë, punoj në klinikë, më ndalohet të flas gjuhën rome me kolegët romë. Shqiptarëve u lejohet e neve jo. Mendoj se nuk duhet të na ndalohet.”

“Në autobus, nëse flas gjuhën rome, më kthehen menjëherë dhe më shikojnë të çuditur - me ç'të drejtë e bëjnë këtë? Kjo është shumë e pakëndshme. Vendi ynë është shumë i vështirë. Kudo që ta vendosësh romin, dikujt do t'i pengojë. Kam jetuar në Gostivar me të gjithë. Këtu habitem që secilit i pengon nga diçka. Unë nuk e dija gjuhën rome, por këtu e mësova - dhe e kuptoj.”

Fokus grupi me përfaqësues nga shkollat

Mësimdhënësit dhe përfaqësuesit e shërbimit profesional të shkollës raportojnë se pengesa më e madhe është mungesa e programit mësimor për mësimin e kësaj lënde, pasi nëse do të kishte program, do të kishte edhe kritere për zgjedhjen e mësimdhënësit.

“Nuk ka kuadër, nuk ka hapësirë, nuk ka kohë, mësimi është shumë vonë. Ndoshta nëse programi shkurtohet, mund të futet diku.”

Rekomandime për përforcimin e zbatimit të masave për realizimin e të drejtës për arsimim në gjuhën amtare

Pyetësor për prindërit

Sugjerimet e prindërve që kanë plotësuar pyetësorin janë në këto drejtime:

- 1) Të futet mësimi në gjuhën rome.
- 2) Të futet një orë shtesë për gjuhën rome ose të bëhet gjysma e mësimin në gjuhën rome.
- 3) Të sigurohet kuadër cilësor dhe tekste shkollore në gjuhën rome.
- 4) Të hapet një departament i gjuhës rome për të siguruar kuadër të kualifikuar mësimit.
- 5) Të punohet më tepër me fëmijët.
- 6) Disa besojnë se fëmijët duhet të mësojnë në maqedonisht, sepse gjuhën rome e dinë nga shtëpia.

Fokus grupi me prindërit

Të organizohet në kuadër të mësimin të rregullt - atëherë këtë e shohin si diçka që duhet bërë dhe ndjekur.

“Nuk kam asgjë kundër, por nëse është orë e rregullt, jo orë shtesë. Nuk mund të bëhet një ndarje e këtillë. Hajde tani, ju jeni komb tjetër, dilni në orë tjetër.”

Fokus grupi me përfaqësues nga shkollat

Të krijohet një program i përshtatshëm mësimit, të ketë kuadër adekuat. Për më tepër, është e nevojshme të mendohet se si të shkurtrohet programi dhe si të futet si një lëndë e rregullt zgjedhore.

“Të përgatitet një strategji e përshtatshme me një program mësimit. Të trajnohet një kuadër adekuat.”

“Të integrohet në programe të tjera.”

SHTOJCA 4: REZULTATET E SONDAZHIT MBI GJUHËN SERBE NË ARSIM

Mostra

Pyetësorit për prindër iu përgjigjën **41 prindër** nga disa vende të shtetit (komunat Aerodrom, Manastir, Rosoman, Shtip, Kumanovë dhe nga qyteti i Shkupit), të cilët deklaruan se fëmija i tyre i përket bashkësisë etnike serbe. Prej tyre, shumica janë nëna (31; 76%), të moshës 31-40 vjeç (25; 61%), me arsim të mesëm (20; 49%).




Figura 1. Moshja e prindërve




Figura 2. Arsimi i prindërve

Numri më i madh i prindërve kanë fëmijë në shkollë fillore (34; 83%), më pas në kopsht (12; 29%) dhe katër (10%) kanë fëmijë që shkon në shkollë të mesme (disa kanë një fëmijë në shkollë fillore dhe një tjetër në kopsht ose në shkollë të mesme). Gjysma e tyre (20; 49%) raportojnë se nuk flasin serbisht në shtëpi, dhe 17 (41%) raportojnë se flasin serbisht dhe një nga gjuhët e tjera lokale, dhe katër (10%) se në shtëpi flasin vetëm serbisht.




Figura 3. Niveli arsimor i fëmijës




Figura 4. Gjuha që flasin në shtëpi

Në fokus grupe morën pjesë 13 prindër (të gjithë nga i njëjti vend) dhe 14 përfaqësues nga dy shkolla (12 mësime dhe 2 përfaqësues nga shërbimi profesional).

REZULTATET

Zbatimi i mësimin në gjuhën serbe

Pyetësor për prindërit

Shumica e prindërve që iu përgjigjën pyetësorit (18; 83%) raportuan se janë të informuar me të drejtën për arsimim në gjuhën amtare të garantuar me ligjet tona. Megjithatë, vetëm një e treta e tyre ishin të informuar për mundësinë e mësimin të gjuhës amtare nga ana e shkollës (12; 29%) dhe kopshtit (2; 5%), ndërsa të tjerët ose nuk ishin informuar (18; 44%) ose nuk e dinin nëse ishin informuar apo jo (9; 22%).




Figura 5. Njohja me të drejtën për arsimim në gjuhën amtare




Figura 6. Informimi për mundësinë e mësimit të gjuhës amtare

Gjysma e prindërve (20; 49%) janë përgjigjur se fëmijët e tyre nuk e mësojnë fare gjuhën serbe në shkollë apo në kopsht. Një numër më i vogël (4; 10%) raportojnë se fëmijët shkojnë në kopsht dhe në shkollë fillore (15; 37%) në gjuhën serbe. (Figura 7).

Ndaj pyetjes se sa pajtohen me pohimin: “Dua që fëmija im të mësojë në gjuhën amtare”, në një shkallë nga 1 - aspak nuk pajtohem deri në 10 - plotësisht pajtohem, shumica e prindërve janë të ndarë: 17 (41%) kanë zgjedhur shkallën më të lartë të pajtimit (10), katër (10%) prej tyre kanë zgjedhur shkallën më të ulët të pajtimit (1), ndërsa shkalla mesatare e pajtimit është 7. (Tabela 2.)

Fokus grupi me prindërit

Të gjithë prindërit në grupin e fokusit ishin nga e njëjta shkollë. Ata thanë se në mjedisin e tyre ka edhe një çerdhe në të cilën ka grup dygjuhësor maqedonisht-serbisht, por nga aty nuk ka pasur pjesëmarrës. Të gjithë të pranishmit janë të njohuar me të drejtën për arsimim në gjuhën amtare.

Shumica e prindërve të pranishëm raportojnë se i flasin të dyja gjuhët në shtëpi, serbisht dhe maqedonisht, si dhe dialektin e Kumanovës. Në shumicën e rasteve, një anëtar i familjes flet serbisht, por edhe pse fëmijët e kuptojnë,

nuk e flasin gjuhën në mënyrë aktive. Nuk ka asnjë prind-pjesëmarrës, fëmija i të cilit mëson në gjuhën serbe. Thonë se ekzistojnë mundësi minimale, por nuk i shfrytëzojnë ato sepse më pas kjo u shkakton vështirësi fëmijëve në përzgjedhjen e shkollës së mesme.

“Tani po përshtatet me një mjedis ku do të duhet të rritet më tej. Ne i flasim ndryshe. Nuk dua t’i përcaktoj një gjuhë, kur të rritet, le të vendosë vetë se cilën gjuhë do të vazhdojë ta flasë.”

“Nuk e shoh këtë opsion si një mundësi që fëmija im të mësojë serbisht - nuk ka mjaft fëmijë.”

Fokus grupi me përfaqësues nga shkollat

Të dyja shkollat mësojnë vetëm në gjuhën maqedonase. Në këto shkolla nuk ka mundësi të tilla dhe ata mendojnë se kjo është rregulluar me ligj. Në Kumanovë dhe rrethinë ka disa shkolla fillore që ofrojnë mësim në gjuhën serbe, por përshtypja e përgjithshme është (jo drejtpërdrejt nga përvoja e pjesëmarrësve, por me të dëgjuar) se interesimi për mësimin e gjuhës serbe është zvogëluar.

Zbatimi i lëndës zgjedhore Gjuha dhe kultura e serbëve

Pyetësor për prindërit

Asnjëri nga prindërit që iu përgjigjën pyetësorit nuk ka deklaruar se fëmija mëson lëndën zgjedhore Gjuha dhe kultura e serbëve.




Figura 7. Zbatimi i masave për mësimin e gjuhës serbe në mësimdhënie

Kur u pyetën për shkallën e pajtimit me pohimin: “Dua që fëmija im të mësojë lëndën Gjuha dhe kultura e bashkësisë sonë” shumica e prindërve u pajtuan plotësisht: 26 (63%) prej tyre zgjedhën shkallën më të lartë të pajtimit (10), 3 (7%) zgjedhën shkallën më të ulët (1), dhe shkalla mesatare e pajtimit është 8. (Tabela 2.)

Fokus grupi me prindërit

Përshtypja e përgjithshme është se jo të gjithë prindërit janë të informuar. Shumica e prindërve thanë se ishte hera e parë që dëgjonin për këtë mundësi, as që e dinin se ekzistonte. Pra, nuk ka pasur anketa të kryera midis të gjithëve, ose ata nuk e kanë kuptuar rëndësinë e tyre. Vitin e kaluar u krye një anketë dhe vetëm katër fëmijë janë paraqitën. Tani presin një përgjigje nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) për të hapur këtë grup, por ende nuk kanë marrë asnjë informacion.

“Jemi dakord që të ketë lëndë zgjedhore, por mësimi të zhvillohet në gjuhën maqedonase.”

“Edhe në shkollën tonë është bërë një anketë - nuk ka nevojë që gjuha mësimore të jetë serbishtja, unë do ta regjistroj në maqedonisht. Mirëpo, shkolla nuk ka nevojë të na pyesë, por duhet të ofrojë mësimin e gjuhës serbe

dhe të na informojë. Ashtu siç ka gjuhë të tjera - anglisht, frëngjisht... dhe nuk është e thënë që ta mësojnë vetëm serbët, por edhe të tjerë.”

“Mendoj se ndoshta nuk janë të informuar sa duhet, nga e gjithë shkolla janë paraqitur vetëm 4 fëmijë dhe atë vetëm nga klasa jonë.”

“Te ne nuk ofrohet, jepen lëndë të tjera zgjedhore, e jo gjuhët [baba që punon në një shkollë të mesme profesionale].

Fokus grupi me përfaqësues nga shkollat

Në shkolla nuk ka lëndë zgjedhore të gjuhës serbe. Përshtypja e përgjithshme është se nuk është e qartë se si informacioni për mundësinë e të paturit të gjuhës serbe si lëndë zgjedhore arrin tek prindërit. Disa thonë se informojnë me fletë vetëm ata prindër, fëmijët e të cilëve janë të regjistruar si serbë apo romë. Nuk u formua asnjë grup sepse ishin paraqitur vetëm 3 fëmijë. Por në përgjithësi, edhe mësimmësuesit pajtohen se interesi i fëmijëve për gjithçka, jo vetëm për gjuhët, ka rënë. Programi është i mbingarkuar dhe fëmijët nuk kanë fare kohë, dhe organizimi i një mësimi të tillë në shkollë është shumë kompleks - të gjitha klasat janë vazhdimisht të zëna (shërbimi profesional tha se nëse ka të paraqitur, do të gjendet një mënyrë për t'i organizuar ato).

Shërbimi profesional mendon se programi i ngarkuar nuk mund të jetë pengesë. Vitet e fundit, në përgjithësi, ka pasur një interes të dobët në të gjitha fushat - fëmijët nuk mësojnë dhe nuk kanë interes (sidomos pas koronës).

“Në një shkollë ofrohet mësim shtesë në gjuhën romë dhe serbe. Kjo filloi të organizohet vitin e kaluar vetëm në mësimin klasor. Kemi kërkuar nga mësimmësuesit të na japin informacion - kështu formohet grupi. Ne i informojmë përmes mësimmësuesve të mësimit klasor dhe formave që ata zgjedhin - mbledhje prindërore apo forma të ngjashme.”

“Numri i të paraqiturve është i vogël - vitin e kaluar ishin vetëm 3 nxënës. Te ne nuk ka pengesa, por vetëm interes të ulët.”

Përfitimet nga zbatimi i masave

Pyetësor për prindërit

Sa i përket pyetjes se sa pajtohen me pohimin: “Mendoj se fëmija do të përparojë më mirë në shkollë nëse mëson në gjuhën amtare” prindërit janë të ndarë: 9 (22%) prej tyre zgjedhën shkallën më të ulët të pajtimit (1), 13 (32%) zgjedhën më të lartën (10), ndërsa shkalla mesatare e pajtimit është 6. Ata më së paku pajtohen me pohimin se mësimi në gjuhët e pjesëtarëve të bashkësive është me cilësi më të ulët se mësimi në gjuhën maqedonase (15;(37%) kanë zgjedhur shkallën më të ulët të pajtimit (1), gjashtë (15%) kanë zgjedhur më të lartën (10), ndërsa shkalla mesatare e pajtimit është 4). (Tabela 2.)

Tabela 2. Qëndrime të prindërve për arsimimin në gjuhën amtare

Ju lutemi tregoni në një shkallë nga 1-10 (1-nuk pajtohem aspak; 10-pajtohem plotësisht) se sa pajtoheni me pohimet e mëposhtme (vlerat mesatare për grupin):	Vlera mesatare
Dua që fëmija im të mësojë në gjuhën amtare.	7
Dua që fëmija im të mësojë lëndën Gjuha dhe kultura e bashkësisë sonë.	8
Besoj se një fëmijë do të përparojë më mirë në shkollë nëse mëson në gjuhën amtare.	6
Besoj se mësimi në gjuhët e pjesëtarëve të bashkësive është më pak cilësor sesa mësimi në gjuhën maqedonase.	4

Fokus grupi me prindërit

Prindërit frikësohen se nëse fëmijët në shkollë fillore mësojnë në gjuhën serbe, do të kenë probleme më vonë në shkollën e mesme, prandaj mes tjetrash, nuk zgjedhin mësimin në gjuhën serbe.

Prindërit që janë pro mësimin të lëndës zgjedhore thonë se *“nacionaliteti ynë është serb, dhe nëse fëmija ynë e mëson gjuhën në shkollë, ai mundet veçse të përfitojë.”*

Disa nga prindërit besojnë se mund të përfitojnë nëse në të ardhmen regjistrohen në fakultet në Serbi.

“Mendoj se duhet të vendoset si lëndë e rregullt zgjedhore dhe të zgjidhet nga kush të dojë, nuk do të thotë ta zgjedhin vetëm serbët.”

“Sa më shumë gjuhë të dinë, aq më mirë për fëmijët. Çfarëdo gjuhe që mësojnë, është pasuri për ta. Fëmijët e mi dinë serbisht, por është ndryshe kur e mësojnë në shkollë - gjuhën letrare.”

Fokus grupi me përfaqësues nga shkollat

Në shkollat e tyre nuk zhvillohet mësim në gjuhën serbe.

“Meqenëse i takojmë një grupi gjuhësor, nuk paraqet ndonjë pengesë që ata të mësojnë maqedonisht për t’u përshtatur në sistem që nga mosha e vogël. Nëse mëson në serbisht, do ta ketë të vështirë më vonë në shkollë të mesme.”

“Numri i fëmijëve të interesuar bie, interesimi i nxënësve për të mësuar serbisht është në rënie (pas shpërbërjes së Jugosllavisë).”

“Mendoj se kjo gjë është e rregulluar ligjërish, ne jemi shkollë njëgjuhësore, prandaj nuk kemi mundësi” (nga Shërbimi profesional)

Pengesat në zbatimin e masave për arsimim në gjuhën amtare

Pyetësor për prindërit

Numër i barabartë i prindërve (7; 17%) të cilët iu përgjigjën pyetësorit e shohin përgjegjësinë për moszbatimin e mësimin në gjuhën amtare serbe në bashkësinë e tyre, për të cilën vlerësojnë se nuk ka interes të mjaftueshëm për këtë mundësi, si dhe në numrin e pamjaftueshëm të fëmijëve për të formuar një paralele.

Një e treta e prindërve (13; 32%) nuk i japin arsyet e mundshme për moszbatimin e mësimin në gjuhën serbe, duke zgjedhur opsionin “tjetër”. Një prind e vendos përgjegjësinë te udhëheqësia e shkollës, mendon se pengesë është mungesa e kuadrit mësimor apo mosekzistenca e teksteve shkollore në gjuhën serbe. Pothuajse një e treta e prindërve (11; 27%) besojnë se është një kombinim i arsyeve të mësipërme.




Figura 9. Arsye për moszbatimit e mësimin në gjuhën serbe (sipas prindërve)

Fokus grupi me prindërit

Prindërit besojnë se një nga pengesat më të mëdha është mungesa e kuadrit adekuat mësuesor. Për më tepër, ata besojnë se statusi ndryshe i lëndës si lëndë zgjedhore e bën atë më pak tërheqëse, prandaj duhet të ofrohet në të njëjtin nivel me lëndët e tjera zgjedhore dhe për të gjithë nxënësit e shkollës.

“Gjetja e një mësimit të përshtatshëm është gjithashtu një sfidë.”

“Nëse vendoset si lëndë zgjedhore në kuadrin e lëndëve të tjera zgjedhore, do të jetë më e lehtë për t’u organizuar. Të mos ofrohet si lëndë për nacionalitete, por si të gjitha lëndët e tjera.”

“Në momentin e regjistrimit, duhet të ketë ndonjë fletushkë, të na informojnë në mbledhje prindërore.”

Fokus grupi me përfaqësues nga shkollat

Si mangësi e shohin faktin se prindërit nuk janë të informuar mjaftueshëm për përparësitë e mësimin të kësaj lënde, ndaj pikërisht për këto arsye shpesh ajo edhe nuk përzgjidhet.

Ata shprehën shqetësimin se ofrimi i mësimin në shumë gjuhë mund të çojë në ndarje më të madhe të fëmijëve.

Besojnë se prindërit duhet të përfshihen më shumë në arsimimin e fëmijëve të tyre.

“Prindërit duhet të informohen më shumë. Ashtu siç i çojnë në kurs të anglishtes, edhe këtu - vetëm se kjo është falas.”

Rekomandime për përforsimin e zbatimit të masave për realizimin e të drejtës për arsimim në gjuhën amtare

Pyetësor për prindërit

Rekomandimet e prindërve që iu përgjigjën pyetësorit më së shumti i referohen ofrimit të kuadrove cilësorë që e njohin mirë gjuhën serbe, por edhe ofrojnë mësimdhënie cilësore, e më pas edhe ofrimit të teksteve shkollore dhe krijimit të programeve efektive nga praktikuesit. Një nga rekomandimet është që pjesëtarët e bashkësive të familjarizohen me të drejtat e tyre.

Fokus grupi me prindërit

Prindërit konsiderojnë se përgjegjësia është e Byrosë për Zhvillimin e Arsimit (BZHA) dhe MASH-it dhe theksojnë se me konceptin e ri disa gjëra do të përmirësohen.

“Ndoshta me konceptin e ri, kur të bashkohen lëndët, do të sigurohen më shumë kushte. Ndoshta do të ketë më shumë mësimdhënës pa fond të mjaftueshëm të orëve - kështu që ndoshta do të ketë më shumë profesorë që do të mund të...”

Ne si prindër duhet të informohemi se si do të organizohet kjo gjë dhe në të njëjtën kohë të kemi informacion edhe për përfitimet. Personalisht nuk e dija deri më sot se kishte një mundësi të tillë.”

“Pyes veten se çfarë po ndodh, çdo vit ka reforma dhe bëhet gjithnjë e më keq. Nuk e di se deri ku do të shkojë kjo.”

Fokus grupi me përfaqësues nga shkollat

Përfaqësuesit e shkollave besojnë se fillimisht duhet bërë një strategji e mirë për të promovuar këtë mundësi dhe si informacion t'u tregohet prindërve se cilat janë përfitimet nga ajo. Më pas, të sqarohet se cili është rregulli për formimin e një grupi. Vetëm atëherë shkolla, duke ndjekur udhëzimet e MASH-it dhe komunës, duhet ta zbatojë aktivitetin në nivel prindëror – t'i informojë dhe ta promovojë këtë mundësi.

“Së pari, prindërit duhet të informohen dhe edukohen - me seminare, takime. Të përfshihen edhe mediat.”

“Shkolla na vendos pengesa, MASH dhe BZHA duhet të kenë një strategji më të mirë. Nuk kemi kuadër. Së pari duhet t'i mbledhim të interesuarit dhe më pas të kërkojmë kuadër. Deri tani nuk kemi kërkuar kuadër sepse nuk ka nxënës të interesuar. Ky projekt u shua sepse nuk kishte të interesuar.

“Qoftë edhe nëse është për dy nxënës, duhet mbajtur grupi, një mësimdhënës duhet të shkojë nga një shkollë në tjetrën.”

Pjesëmarrësit nuk ishin të sigurt se si e rregullon ligji këtë çështje - qoftë me nëntë apo më shumë nxënës. Por ata arritën në përfundimin se mund të formohet një grup me nëntë nxënës nga një gjeneratë.

“Të gjithë le të mësojnë në gjuhën e tyre amtare, por me analiza paraprake të thella se si ta bëjnë këtë.”

“Prindërit duhet ta marrin seriozisht nevojën për të mësuar gjuhë duke respektuar dallimet, por jo për të jetuar të ndarë dhe në geto.”

Formimi i klasave në të gjitha shkollat është diçka e rrezikshme, ku do të gjenden mësimdhënësit? Nuk do të vijmë fëmijë, jam skeptik. Por duhet menduar se si do të inkuadrohet brenda ligjit.”

“Duhet të ofrohet mundësia, duke respektuar bashkësitë e tjera, të mos mbyllemi vetëm në gjuhën tonë amtare, por të jemi të hapur për të gjithë.”

Është e nevojshme t'u mundësohet mësimi i gjuhës amtare si lëndë zgjedhore. Mirëpo duhet t'i kushtohet vëmendje promovimit, qoftë edhe përmes medias. Por kjo të jetë vetëm si lëndë zgjedhore, që të mos ketë segregim mes nxënësve.

“Nxënësit janë të mbingarkuar. Nuk është keq që të dilet me një opsion për ta bërë lëndë të detyrueshme. Por gjithsesi është e nevojshme të informohen prindërit - sepse ata vendosin për fëmijët e tyre. Shteti duhet të punojë në baashkëpunim me prindërit.”

“Duhet të ekzistojë si lëndë zgjedhore, por megjithatë duhet të ketë më shumë përfshirje të institucioneve, po edhe të shoqatave dhe partive që e mbështesin bashkësinë serbe.”

SHTOJCA 5: REZULTATET E HULUMTIMIT MBI GJUHËN TURKE NË ARSIM

Mostra

Pyetësorit për prindër iu përgjigjën **40 prindër** nga disa vende të shtetit (disa komuna të Shkupit dhe fshatra të rrethinës, Shtipi, Karbinci dhe Velesi), të cilët deklaruan se fëmija i tyre i përket bashkësisë etnike turke. Prej tyre, më së shumti janë baballarë (21; 53%), të moshës 31-40 vjeç (18; 45%), me arsim të mesëm (16; 40%).




Figura 1. Moshë e prindërve




Figura 2. Arsimi i prindërve

Shumica e prindërve kanë fëmijë në shkollë fillore (32; 80%), 18 (45%) nga prindërit kanë fëmijë në shkollë të mesme, ndërsa disa i kanë në kopsht (10%) (disa kanë një fëmijë në shkollë fillore dhe tjetrin në shkollë të mesme ose në kopsht). Shumica prej tyre (18; 45%) raportojnë se flasin vetëm turqisht në shtëpi, dhe 16 (15%) raportojnë se flasin një nga gjuhët e tjera lokale përveç turqishtes, ndërsa gjashtë (15%) prindërit e mbetur deklarojnë se nuk flasin turqisht në shtëpi.




Figura 3. Niveli arsimor i fëmijës




Figura 4. Gjuha që flasin në shtëpi

Në fokus grupe morën pjesë shtatë prindër dhe 11 përfaqësues nga mësimdhënësit (9) dhe nga shërbimi profesional (2) i shkollave.

REZULTATET

Zbatimi i mësimin në gjuhën turke

Pyetësor për prindërit

Shumica e prindërve që iu përgjigjën pyetësorit (34; 85%) raportuan se janë të njohur me të drejtën për arsimim në gjuhën amtare të garantuar me ligjet tona. Megjithatë, më pak se gjysma e tyre ishin të informuar për mundësinë e mësimin të gjuhës amtare nga ana e shkollës (17; 42%), ndërsa më shumë se gjysma ose nuk ishin informuar (15; 38%) ose nuk e dinin nëse ishin informuar apo jo (8; 20%).




Figura 5. Njohja me të drejtën e arsimit në gjuhën amtare




Figura 6. Informimi për mundësinë e mësimit në gjuhën amtare

Një e treta e prindërve (16; 33%) janë përgjigjur se fëmijët e tyre mësojnë në gjuhën amtare në shkollë fillore dhe 12 (25%) në shkollën e mesme. (Figura 7).

Ndaj pyetjes se sa pajtohen me pohimin: “Dua që fëmija im të mësojë në gjuhën amtare”, në një shkallë nga 1 - aspak nuk pajtohem deri në 10 - plotësisht pajtohem, prindërit janë të ndarë: gjashtë (15%) prej tyre zgjodhën shkallën më të ulët të pajtimit (1), 22 (55%) zgjodhën më të lartën (10), ndërsa shkalla mesatare e pajtimit është 8. (Tabela 2.)

Fokus grupi me prindërit

Përshtypja e përgjithshme është se prindërit i regjistrojnë fëmijët e tyre në gjuhën maqedonase që të mos kenë probleme kur të regjistrohen në klasë të gjashtë.

Kur vijnë në klasën e gjashtë, sukcesi i tyre bie në mënyrë drastike, ata nuk marrin asnjë pesë. Mësimdhënësi më thotë se di mirë, mëson mirë gjermanisht, por nuk mund të marrë më shumë se dysh - si të gjithë nxënësit e tjerë.”

Të gjithë të pranishmit konfirmuan se kanë të njëjtin problem edhe me mësimdhënësit të cilët, përkundër përpjekjeve të fëmijëve, nuk u japin nota

më të larta vetëm për shkak se nuk dinë maqedonisht, pavarësisht se për cilën lëndë bëhet fjalë. E gjithë kjo shkaktoi një revoltë te prindërit.

Të gjithë pjesëmarrësit konfirmuan se e dinë se fëmija i tyre ka të drejtën që të mësojë në gjuhën amtare dhe që të gjithë ishin dakord se në atë mënyrë do ta kenë më të lehtë të shprehen, të kuptojnë njëri-tjetrin dhe se do të kishin më shumë sukses.

“Kur fëmija im mësonte në turqisht kishte sukses shumë të lartë, kur erdhi në shkollën qendrore nuk mundej të merrte nota të larta.”

“Unë kam një propozim tjetër, që fëmijët të vazhdojnë në turqisht nga klasa e gjashtë, domethënë t’u jepet mundësia që të vazhdojnë të mësojnë në gjuhën e tyre amtare (ndoshta 70% janë turq në këtë shkollë). Le të mësojnë edhe në gjuhën maqedonase dhe atë më shumë orë, se ne jetojmë këtu - në Maqedoni. Kur mësoja unë, nuk e kisha të vështirë, sepse e dija maqedonishten, por shokët e mi të klasës qanin shumë, ishte shumë e vështirë për ta, nuk kuptonin ... dhe 70% e klasës ishin turq, kështu që nuk kishim me kë ta mësojmë dhe ta praktikojmë maqedonishten.

Fokus grupi me përfaqësues nga shkollat

Mësimdhënësit dhe përfaqësuesit ishin nga e njëjta shkollë me disa shkolla rajonale. Në shkollat rajonale, (disa prej tyre) deri në klasën e pestë, mësimi zhvillohet në gjuhën turke, në disa në gjuhën maqedonase, ndërsa në disa të tjera ka paralele edhe maqedonase edhe turke (1) deri në klasën e pestë. Nga klasa e gjashtë të gjithë nxënësit kalojnë në shkollën qendrore dhe mësojnë në gjuhën maqedonase. Ka 9 shkolla rajonale, prej të cilave 4 zhvillojnë mësimin në turqisht, ndërsa tjerat në maqedonisht. Turqishtja mësohet në lagjet me shumicë turke dhe vetëm në një shkollë nxënësit kanë mundësi të zgjedhin. Për ata nxënës organizohet transport, i cili i çon nxënësit nga vendbanimi deri në shkollën qendrore.

Gjatë prezantimit, vazhdimisht përsëritej se gjuha maqedonase mësohet nga klasa e katërt, kurse anglishtja nga klasa e parë, që konsiderohet si disavantazh.

Në vendbanimet me popullsi dominuese turke, deri në klasën e pestë ofrohet mësim në turqisht, në klasat e tjera ofrohet në gjuhën maqedonase dhe vetëm njëra prej tyre ofron mundësinë për të zgjedhur turqisht ose maqedonisht.

Zbatimi i lëndës zgjedhore Gjuha dhe kultura e turqve

Pyetësor për prindërit

Vetëm katër prindër (8%) raportuan se fëmija i tyre mëson lëndën zgjedhore Gjuha dhe kultura e turqve (GJKT).




Figura 7. Zbatimi i masave për mësimin e gjuhës turke në mësimdhënie

Kur u pyetën për shkallën e pajtimit me pohimin: “Dua që fëmija im të mësojë lëndën Gjuha dhe kultura e bashkësisë sonë” shumica e prindërve u pajtuan plotësisht: 28 (70%) prej tyre zgjedhën shkallën më të lartë të pajtimit (10), 3(8%) zgjedhën shkallën më të ulët (1), dhe shkalla mesatare e pajtimit është 9). (Tabela 2.)

Fokus grupi me prindërit

Prindërit nuk kanë marrë anketë për lëndën zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive më të vogla.

Një prind tha se ka dëgjuar se nuk ka mësimdhënës që do të jepnin këtë lëndë, por një prind tjetër tha të kundërtën, se ka mësimdhënës që nuk kanë as orë të mjaftueshme, kështu që me këtë do ta plotësonin fondin. Ata nuk e dinë arsyen pse nuk është bërë një anketë.

Edhe në këtë grup u tha se problemi qëndron në faktin se, gjuha maqedonase në vend që të mësohet nga klasa e parë, mësohet nga klasa e katërt, e kur nxënësit mbërrijnë në klasë të gjashtë, adaptimi u shkakton probleme.

“Turqishtja mbase mund të mësohet si lëndë zgjedhore, por gjithashtu disa lëndë mund të zhvillohen në turqisht. Kështu zhvillohet themeli te fëmijët, kështu do të shprehen më lehtë.”

Fokus grupi me përfaqësues nga shkollat

Sipas pedagoges, anketat kryhen me prindërit e nxënësve të klasës së katërt dhe duke qenë se nuk ka numër të mjaftueshëm të nxënësve, lënda zgjedhore e gjuhës turke nuk ofrohet. Mësimdhënësit nuk u pajtuan që lënda të ofrohet nga klasa e katërt, ndërsa një mësimdhënëse dha se në grupin e tyre nuk bëhen anketa. Mësimdhënësit u habitën që gjuha turke ofrohej si lëndë zgjedhore, nuk kishin qenë të vetëdijshëm për një mundësi të tillë.

Në paralelet maqedonase ku ka turq, mësimdhënësit thanë se nuk ka lëndë zgjedhore. Shërbimi profesional tha se anketa zbatohet dhe se nuk ka mjaft fëmijë, ndërsa mësimdhënësit thanë se nuk kishin parë të ofrohej një mundësi e tillë. Ata reaguesan pasi nuk kishin një informacion të tillë dhe madje kërkonin prova nga shërbimi profesional.

Përfitimet nga zbatimi i masave

Pyetësor për prindërit

Sa i përket pyetjes se sa pajtohen me pohimin: “Mendoj se fëmija do të përparojë më mirë në shkollë nëse mëson në gjuhën amtare” prindërit janë të ndarë: 7 (18%) prej tyre zgjedhën shkallën më të ulët të pajtimit (1), 23 (58%) zgjedhën më të lartën (10), ndërsa shkalla mesatare e pajtimit është 7. Ata më së paku pajtohen me pohimin se mësimi në gjuhët e pjesëtarëve të bashkësive është me cilësi më të ulët se mësimi në gjuhën maqedonase (13 (33%) kanë zgjedhur shkallën më të ulët të pajtimit (1), 9 (23%) kanë zgjedhur më e lartën (10), ndërsa shkalla mesatare e pajtimit është 5) . (Tabela 2.)

Tabela 2. Qëndrime të prindërve për arsimimin në gjuhën amtare

Ju lutemi tregoni në një shkallë nga 1-10 (1-nuk pajtohem aspak; 10-pajtohem plotësisht) se sa pajtoheni me pohimet e mëposhtme (vlerat mesatare për grupin):	Vlera mesatare
Dua që fëmija im të mësojë në gjuhën amtare	8
Dua që fëmija im të mësojë lëndën Gjuha dhe kultura e bashkësisë sonë.	9
Besoj se një fëmijë do të përparojë më mirë në shkollë nëse mëson në gjuhën amtare.	7
Besoj se mësimi në gjuhët e pjesëtarëve të bashkësive është më pak cilësor sesa mësimi në gjuhën maqedonase.	5

Fokus grupi me prindërit

Prindërit besojnë se përfitimi kryesor i mësimin në gjuhën amtare është se fëmija do të shprehet më lehtë dhe do të jetë më i suksesshëm. Por ata theksojnë se nuk u ofrohet një mundësi e tillë.

Fokus grupi me përfaqësues nga shkollat

Si anë pozitive, ata shohin mundësinë që fëmijët të shprehen në gjuhën që njohin, të mësojnë gjuhën letrare turke sepse në shtëpi flasin në dialekt, gjë që rrit mundësitë për t'u regjistruar në fakultet ose në shkollë të mesme në gjuhën e tyre amtare dhe tregojnë rezultate më të mira në aspektin e të nxënës, ndryshe nga periudha kur vazhdojnë mësimin në gjuhën joamtare në klasën e gjashtë.

“Është gjë e mirë - sa më shumë gjuhë të dini, aq më mirë. Ne përfshihemi në projekte, është mirë që ata ta mësojnë gjuhën, do ta dinë gjuhën e tyre më mirë.”

“Kemi fëmijë që shkojnë në shkollë të mesme në Gostivar për shkak të turqishtes ose regjistrohen në universitet në gjuhën turke. Më pas hasin vështirësi sepse nuk vazhdojnë të mësojnë turqishten si lëndë zgjedhore. Kur nuk e mësojnë nga klasa e gjashtë, nuk është mirë, sepse e harrojnë gjuhën.”

Pengesat në zbatimin e masave për arsimim në gjuhën amtare

Pyetësor për prindërit

Një e treta (13; 33%) e prindërve që iu përgjigjën pyetësorit nuk japin arsytet e mundshme për moszbatimin e mësimin në gjuhën turke, duke zgjedhur opsionin “tjetër”, dhe një e katërta e prindërve (10; 25%) besojnë se kjo është për shkak të një kombinimi të më shumë arsyeve të mundshme të përmendura. Shtatë (17%) mendojnë se arsyeja kryesore është se nuk ka mësimdhënës që do të jepnin mësim në turqisht, dhe katër (10%) mendojnë se arsyeja është se nuk ka tekste shkollore në gjuhën turke. Një pjesë e vogël besojnë se nuk ka vullnet nga ana e drejtorisë së shkollës (3; 8%) dhe nuk ka numër të mjaftueshëm të fëmijëve për të formuar klasë (3; 7%).




Figura 9. Arsye për moszbatimin e mësimin në gjuhën turke (sipas prindërve)

Fokus grupi me prindërit

Të gjithë pjesëmarrësit u pajtuan se fëmijët e tyre në shkollën qendrore diskriminohen sepse, sipas tyre, fëmijët nuk kanë nota më të larta se tresh, ndërsa në shkollë të mesme të gjithë marrin pesë. Ata besojnë se këtu fëmijët e tyre diskriminohen nga mësimdhënësit.

“Ata nuk mund të tregojnë sukses, siç do të bënin në gjuhën e tyre amtare.”

Fokus grupi me përfaqësues nga shkollat

Përfaqësuesit e shkollave mendojnë se pengesa më e madhe për arsimim në gjuhën turke është mungesa e teksteve shkollore në gjuhën turke. Është

konstatuar se ky problem ekziston me të gjitha gjuhët e mësimdhënies, por ata konsiderojnë se është veçanërisht i theksuar me gjuhën turke. Këtu u përmend se problemi është se gjuha maqedonase nuk mësohet nga klasa e parë, dhe këta fëmijë duhet të vazhdojnë në gjuhën maqedonase nga klasa e gjashtë, si pasojë suksesi i tyre bie në mënyrë drastike.

Përshtypja e përgjithshme ishte se disa nga mësimdhënësit ishin të befashuar nga kjo mundësi, sikur të mos e dinin se ekzistonte. Kur e morën vesh, mbështetën mundësinë dhe menduan se shkolla duhet të bëjë më shumë përpjekje për t'i informuar prindërit si për përfitimet, ashtu edhe për përparësitë. Njëkohësisht të përpiqet që të ofrojë kushte - organizim të transportit të përshtatshëm dhe kombinimi i tij me mundësinë për të qëndruar pas orëve.

“Kemi kuadër, por nuk po bëhet asgjë e veçantë.”

“Kjo gjë mund të organizohet edhe në shkollat qendrore në mënyrë fakultetive, kemi kuadër të mjaftueshëm.”

“Koordinimi me autobusët mund të jetë problem - ekziston një autobus që mbledh të gjithë nxënësit në një kohë të caktuar. Ka fëmijë që udhëtojnë 50 km në ditë dhe kështu janë të varur nga transporti - me siguri kjo është arsyeja se pse nuk i regjistrojnë.”

Një mësimdhënës sugjeroi që kjo të organizohej nga vetë shkolla dhe në ditët kur fëmijët kanë 5 orë. Ky propozim u mbështet nga të gjithë mësimdhënësit. Nga shërbimi profesional thanë se kjo varet nga drejtori. Rreth kësaj çështjeje u zhvillua një debat mjaft i ashpër.

Rekomandime për përforcimin e zbatimit të masave për realizimin e të drejtës për arsimim në gjuhën amtare

Pyetësor për prindërit

Rekomandimet e prindërve që iu përgjigjën pyetësorit janë kryesisht në drejtim të ofrimit të kuadrit mësimor cilësor, teksteve shkollore dhe burimeve të tjera të nevojshme. Disa theksojnë se punësimet politike duhet të ndërpriten për të lejuar angazhimin e kuadrit cilësor në shkolla.

Fokus grupi me prindërit

Qëndrimi i prindërve është që të krijojnë kushte të përshtatshme për adaptimin e fëmijëve kur vazhdojnë në gjuhën maqedonase në klasën e gjashtë, të kenë mbështetje, të kenë ndonjë mësimdhënës turk për mbështetje, dhe kur fëmija të ketë problem, të jetë në gjendje të kërkojë ndihmë nga ai.

Gjuha maqedonase duhet të mësohet nga klasa e parë deri në klasën e nëntë në klasat turke.

“Të ketë ndonjë mësimdhënës turk për mbështetje, kur fëmija të ketë problem, të vijë dhe të kërkojë ndihmë nga ai mësimdhënës.”

Përshtypja e përgjithshme është se prindërit nuk kanë informacion se ekziston mundësia për të studiuar lëndën zgjedhore Gjuha dhe kultura e turqve. Kur e kuptuan, propozuan që ajo të ishte lëndë e detyrueshme dhe ta mësonin të gjithë fëmijët turq. Ata kërkuan të kishin një mësimdhënës të tillë në shkollë. Rekomanduan gjithashtu që t'u shpjegohet më shumë prindërve arsyeja se pse mësimi i turqishtes është i rëndësishëm - dhe jo vetëm ta shohin atë si një ngarkesë shtesë.

“Ashtu siç ka anglisht nga e para deri në të nëntën, ashtu duhet të ketë turqisht. Ne kërkuam njëherë dhe na thanë se nuk ka kuadër.”

“Këtu mund të ndihmojë kryetari i komunës, të japë një urdhër dhe vendim, si dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH).”

“Kryetari nuk na ndihmon fare, ndihmon vetëm në fshatrat ku ka maqedonas, jo në fshatrat tanë.”

“Këtu na janë hequr të drejtat. Në Shkup është ndryshe, jepen të drejta. Këtu jemi si jetimë, si pa nënë e pa baba. Nuk na lejohet as të flasim. Pak është dhe faji ynë, kur dikush ka problem në komunë, ne qeshim - nuk i ndihmojmë.”

“Edhe nga Shkupi duhet të vijnë të na shohin, të na pyesin nëse kemi ndonjë problem, nëse kemi kushte - kështu siç erdhët ju të na pyesni tani. Por të vini atje lart - te shkollat tona, t'i shikoni shkollat tona në çfarë gjendje janë, sa të pista.”

Ata thanë se kushtet në shkollat rajonale me turq janë më të këqija se kushtet në shkollat rajonale me maqedonas.

“Prindërit e tjerë janë si ne, por ata nuk mund të shprehen, ata gjithashtu nuk besojnë se diçka do të ndryshojë dhe heqin dorë nga kërkesat.”

Ju, deri sa të mundeni dhe deri ku të doni tregoni se këtu nuk kemi gjuhë amtare deri në klasën e nëntë dhe shkollat tona janë në kushte shumë të këqija. Pse mos të mësojnë edhe fëmijët tanë, e jo të bëhen fermerë. Ne kemi nevojë për dikë që të na ndihmojë, këtu jemi vetëm - ne jua themi ju, e ju përcillenit atje ku duhet.”

“Për shtetin - të ketë një përkthyes për turqishten në institucione, t'i ndihmojë njerëzit që shkojnë të kërkojnë dhe nxjerrin dokumente.”

“Ka fëmijë që thonë se kot që mësojnë, nuk janë të motivuar. Duhet të gjendet një mënyrë për t'i motivuar këta fëmijë.”

Fokus grupi me përfaqësues nga shkollat

Qëndrimi i mësimdhënësve është që t'i kushtohet më shumë vëmendje dhe përfshirje prindërve në jetën e fëmijëve. T'u jepet më shumë rëndësi mësimdhënësve dhe nxënësve, të ketë më shumë interes nga ana e prindërve. Fakti që vazhdojnë në gjuhën maqedonase u shkakton problem, nuk mund të shprehen maqedonisht dhe tërhiqen, nuk flasin, problemi është se ata nuk e njohin mjaftueshëm gjuhën maqedonase, prandaj duhet të mësojnë paralelisht maqedonishten dhe turqishten që nga klasa e parë.

Rekomandim tjetër është që të punohet për shtimin e kuadrit për gjuhën turke, edhe pse një pjesë e mësimdhënësve mendojnë se ka kuadër të mjaftueshëm, se ka mësimdhënës që nuk kanë as orë të mjaftueshme, kështu që mund t'i plotësojnë.

U zhvillua një diskutim rreth asaj se çfarë lloj lënde është gjuha turke (nuk e dinin nëse ishte zgjedhore) – dhe kur e kuptuan, thanë se do të ishte mirë që gjuha turke të bëhej lëndë e detyrueshme në shkollën e tyre; Duhet të ndryshohet kriteri për të paktën 15 fëmijë, të përshtatet numri i nxënësve, sepse ndonjëherë as numri i përgjithshëm i nxënësve nuk është më i madh se 15.

“MASH dhe Byroja për Zhvillimin e Arsimit (BZHA) - librat shkollorë duhet të sigurohen me kohë.”

“Të rritet numri i orëve të gjuhës maqedonase në mësimin klasor që fëmijët të mos kenë më probleme në përshtatje në klasën e gjashtë. Gjuha maqedonase të mësohet që nga klasa e parë në klasat me mësim në gjuhën turke.”

“Për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet e tjera - t’i kushtojnë më shumë vëmendje gjuhës amtare. Të ketë më shumë projekte në ato gjuhë që fëmijët të mund të mësojnë në atë gjuhë. Për shembull, fëmijët turq nuk e dinë turqishten, prindërit thonë se fëmijët e tyre nuk e dinë, por ata nuk janë të vetëdijshëm që fëmijët e tyre nuk e dinë gjuhën letrare turke. Të bëhet një projekt për të rritur ndërgjegjësimin e prindërve rreth nevojës për ta mësuar gjuhën letrare turke.”

“Ua kalojmë përgjegjësinë prindërve, por nëse 50% e fajit bie tek prindërit, atëherë 50% është edhe tek ne. Ne duhet t’i afrojmë sepse nuk dinë. Duhet t’i bëjmë të interesohen dhe t’i afrojmë.”

SHTOJCA 6: REZULTATET E PYETËSORIT PËR SHKOLLA

Mostra

Pyetësi u plotësua nga përfaqësues të **55 shkollave**. Prej tyre **24 janë pedagogë, 15 psikologë, 8 drejtorë** dhe **8 punonjës** të tjerë të shkollës.

Zbatimi i lëndës zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive

Numri më i madh i shkollave (48; 87%) raportojnë se të punësuarit janë plotësisht të vetëdijshëm për të drejtën e pjesëtarëve të bashkësive për të mësuar gjuhën amtare si lëndë zgjedhore ose të rregullt gjatë mesimdhënies.




Figura 1. Njohja e punonjësve të shkollës me të drejtën për arsimim në gjuhën amtare

Nga gjithsej 55 shkolla, në 45 prej tyre (82%) lënda Gjuhë dhe kulturë nuk mësohet për asnjë nga bashkësitë më të vogla. Pesë shkolla (9%) raportuan se mësohet lënda Gjuha dhe kultura e romëve dhe e vlllehëve dhe një shkollë (2%) se mësohet e gjuha dhe kultura e boshnjakëve dhe turqve.




Figura 2. b) Mësimi i lëndës Gjuha dhe kultura e pjesëtarëve të bashkësive më të vogla

Vetëm nëntë nga dhjetë shkolla ku zbatohet lënda zgjedhore Gjuhë dhe kultura e bashkësive raportojnë për gjendjen numerike të nxënësve. Nga Tabela 2. mund të shihet se numri i nxënësve që ndjekin këtë lëndë ndryshon nga një shkollë në tjetrën, duke filluar nga 3 deri në 65 nxënës. Në dy nga këto nëntë shkolla, zhvillohen nga dy lëndë zgjedhore Gjuhë dhe kulturë, për nxënësit e dy bashkësive.

Gjuha dhe kultura e boshnjakëve mësohet në një shkollë me 13 nxënës.

Tabela 2. Numri i nxënësve që ndjekin lëndën Gjuhë dhe kulturë

Shkolla	GJK e boshnjakëve	GJK e vlllehëve	GJK e romëve	GJK e turqve
SH1		17		11
SH2	13			
SH3			18	
SH4			50	
SH5			50	
SH6		15		
SH7		3		
SH8		3		
SH9		15	65	

Pengesat në zbatimin e masave për arsimim në gjuhën amtare

Në pyetjen për arsyet e moszbatimit të lëndës Gjuhë dhe kulturë janë përgjigjur 40 shkolla, nga të cilat 26 (47%) shkolla vlerësojnë se nuk ka interesim nga ana e prindërve dhe nxënësve. Nga 13 (24%) shkolla raportojnë se arsyeja e moszbatimit të lëndës zgjedhore është numri i pamjaftueshëm i nxënësve për të formuar grup, dhe vetëm nga një shkollë (2%) mendojnë se nuk ka kuadër adekuat për të dhënë lëndën zgjedhore..




Figura 3. Arsyet e moszbatimit të mësimit të gjuhës në bashkësi

Shumica e shkollave (49; 89%) deklaruan se kryejnë një anketë midis prindërve për atë se cilat lëndë zgjedhore do të donin që fëmijët e tyre t'i mësonin dhe 4 (7%) shkolla raportojnë se e bëjnë këtë përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me prindërit.




Figura 4. Mënyra e informimit të prindërve për lëndën zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive

Numri më i madh i shkollave, 47 (85%), raportojnë se rezultatet e anketës ua prezantojnë prindërve të nxënësve. Në rast të numrit të pamjaftueshëm të nxënësve të paraqitur dhe duke ndjekur kriterin e të paktën 15 nxënësve që nevojiten për të formuar një grup, 24 (44%) shkolla nuk formojnë klasë, duke njoftuar prindërit se nuk ka numër të mjaftueshëm të nxënësve për formimin

e një klase. Dhjetë (18%) shkolla po përpiqen të tërheqin më shumë fëmijë nëpërmjet bisedave me prindërit. Vetëm disa shkolla bëjnë përpjekje shtesë për të formuar një klasë për mësimin e lëndës zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive dhe një e treta e shkollave nuk shprehen mbi këtë çështje.




Figura 5. Si veprojnë shkollat kur nuk ka nxënës të mjaftueshëm të paraqitur për lëndën zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive

Nga 15 (27%) shkolla raportojnë se i dorëzojnë kërkesat për tekste shkollore për lëndën zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive në kohë në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH).

Kuadri mësimor për lëndën zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive

Vetëm 12 (22%) shkolla raportojnë se kuadri mësimor është në përputhje me normën e paraparë me programin mësimor Gjuha dhe kultura e bashkësive dhe puna e tyre monitorohet nga dikush nga shkolla.

Dhjetë (18%) shkolla raportojnë se shkolla u ofron mbështetje mesimdhënësve për realizimin e lëndës zgjedhore, kryesisht përmes punës këshillimore-konsultative, mbështetjes metodologjike dhe tekniko-didaktike, bisedave, trajnimeve, ofrimit të kushteve të punës, mbështetjes në bashkëpunimin me prindërit, dhe në një shkollë me shtimin e fondit të mësimin.

Nga 23 (42%) shkolla raportojnë se mesimdhënësit që ligjërojnë lëndën zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive janë të përfshirë në trajnime, së bashku me kolegët e tjerë.

SHTOJCA 7: REKOMANDIME NGA FORUMI PJESËMARRËS

Rekomandimi 1:

Të bëhen ndryshime në ligjin për arsim parashkollor dhe fillor për të reduktuar numrin e nxënësve që të formohet një grup/klasë.

Në ligjet për arsimin parashkollor si dhe arsimin fillor, numri minimal i nevojshëm i nxënësve për të formuar një grup, pra një klasë për mësimin e gjuhës së bashkësisë, është 15. Ky numër duhet të zvogëlohet, për të mbuluar një numër më të madh të nxënësve që do të mësojnë gjuhën e tyre amtare.

Rekomandimi 2:

Lënda zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive më të vogla duhet të ketë të njëjtin status si lëndët e tjera zgjedhore dhe të mund të zgjidhet nga çdo nxënës, pavarësisht nga përkatësia etnike.

Lënda zgjedhore Gjuha dhe kultura e bashkësive më të shumti ofrohet nga shkollat si lëndë e tretë zgjedhore dhe është e destinuar vetëm për nxënësit që janë pjesëtarë të asaj bashkësie, me pëlqim nga prindi, ndërsa për lëndët e tjera zgjedhore procedura është krejtësisht ndryshe, sepse ato ofrohen si prioritare.

Rekomandimi 3:

Të bëhen ndryshime në ligjin për tekste shkollore dhe ligjin për veprimtarinë botuese për të siguruar përkthim dhe lektorim cilësor të teksteve në gjuhët e bashkësive më të vogla.

Rekomandimi 4:

Të vendosen masa afirmative për përzgjedhjen e recensentëve të dorëshkrimeve për tekstet shkollore në gjuhët e bashkësive më të vogla.

Në përputhje me ligjin e teksteve shkollore, një recensent duhet të ketë së paku dhjetë vjet përvojë profesionale në lëndën për të cilën synohet dorëshkrimi. Duke pasur parasysh që mësimdhënësit janë të rrallë, me normativin e parashikuar në Programin mësimor, është e nevojshme të bëhet një ndryshim me të cilin do të miratohet një recensent me përvojë më të vogël për gjuhët e bashkësive më të vogla.

Rekomandimi 5:

Përgatitja e teksteve shkollore për lëndët zgjedhore Gjuha dhe kultura e romëve, serbëve dhe turqve, si dhe manuale dhe materiale të tjera mësimore për të gjitha bashkësitë.

Bashkësia rome nuk ka tekste shkollore për lëndën zgjedhore Gjuha dhe kultura e romëve për klasën e gjashtë, të shtatë, të tetë dhe të nëntë, ndaj për këtë nevojitet një përpjekje shtesë në bashkëpunim me bashkësinë rome dhe me ndihmën e profesorëve universitarë që të përgatiten tekste shkollore për klasat ku nuk ka.

Rekomandimi 6:

Përgatitja e programit mësimor për lëndën Gjuha serbe në arsimin e mesëm.

Për realizimin e mësimdhënies nevojiten edhe programe mësimore, që është përgjegjësi e BZHA.

Rekomandimi 7:

Të ndahen burime financiare për vitin e ardhshëm kalendarik për të gjitha nivelet e arsimit, sipas nevojave në nivel lokal (p.sh. për grupet dygjuhësore në kopshte, për transportin e fëmijëve nga zonat e largëta etj.).

Rekomandimi 8:

Të forcohen në mënyrë të vazhdueshme kapacitetet e kuadrit ekzistues dhe të ardhshëm (gjatë studimeve) edukativo-arsimor për gjuhët e bashkësive më të vogla.

Rekomandimi 9:

Të mundësohet mësimi i gjuhëve të bashkësive në universitete.

Për mësimdhënie cilësore, sidomos kur bëhet fjalë për gjuhën, mësimdhënësi që e jep atë lëndë duhet ta përvetësojë dhe ta përcjellë gjuhën standarde dhe letrare, sepse vetëm në atë formë duhet përdorur gjatë mësimdhënies me nxënësit. Por për një kuadër të tillë nevojitet edhe aftësia, e cila fitohet në institucionet e arsimit të lartë. Për momentin, gjuhët e bashkësive më të vogla nuk mësohen fare në universitete. Duhet të sigurohet mësimi i tyre, qoftë si lëndë zgjedhore, qoftë duke siguruar një model të përshtatshëm për mësimin e tyre.

Rekomandimi 10:

Të sigurohen bursa studimi për të rinjtë, të cilët pas shkollimit të mesëm do të vazhdojnë në Fakultetet pedagogjike, në mënyrë që të rritet numri i kuadrit pedagogjik.

LITERATURA E PËRDORUR

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, 2006
- Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, <http://www.amos.org.mk>;
- Rekomandimet e KLPK-së të OSBE-së nga Haga për të drejtat arsimore të pakicave kombëtare;
- Ligji për arsim fillor, “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 161/19 dhe 229/20
- Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Moldavisë” nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18, 198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 104/19, 146/19, 275/19, 311/20, 294/21 dhe 150/ 22)
- Koncepti për arsimin fillor nëntëvjeçar 2007.
- Studim për multikulturalizmin dhe marrëdhëniet ndëretnike në arsim www.unicef.org.mk
- Strategjia për arsimin e integruar, 2010.
- Hulumtim “Kushtet në arsimin fillor të fëmijëve të bashkësive në Republikën e Maqedonisë 2010”.
- Ligji për tekstet shkollore për arsimin fillor dhe të mesëm (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 98/2008, 99/2009, 83/2010, 36/2011, 135/2011, 46/2012, 24/2013, 24/2013, 12 2013, 29/2014, 146/2015, 217/2015, 30/2016 dhe 21/2018)
- Ligji për avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pjesëtarëve të bashkësive që janë më pak se 20% e popullsisë së përgjithshme në RMV 2020.
- Enti Shtetëror i Statistikës <http://popis2021.stat.gov.mk/>
- Arsimi në gjuhët e bashkësive më të vogla etnike - hulumtim https://fosm.mk/wp-content/uploads/2020/04/obrazovanie-na-jazicite-na-pomalubrojnite-etnicki-zaednici_06.pdf

Financuar nga:



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Shkup